



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 3
03.07.2017

NR. VENDIMI 11
18.05.2018

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej:

Gjyqtar: Sandër Simoni

Gjyqtare: Irena Gjoka

Gjyqtare: Marsela Balili

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Alma Ramaj**, sot në datë 18.05.2018, në Tiranë, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, publike, kërkesën penale **Nr.3/26 Regjistri Themeltar**, që i përket palëve:

PADITËS:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga prokurorja **Pranvera Pustina**.

IPADITUR:

1) **Sh. B.**, i biri i S. dhe i M., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx dhe banues në fshatin xxxx, Komuna xxxx, me shtetësi shqiptare, i martuar me x fëmijë, me arsim xxx, përfaqësuar në gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij me deklaram në seancë avokat K. B., Avokat i Dhomës së Avokatisë xxxx, me adresë selie Rruga “xxxx”, Lagjja Nr. x, banesa Nr. xx, xxxx.

2) **M. B.**, e bija e Q. dhe e R., e datëlindjes xxxx, lindur në xxxx dhe banues në fshatin xxxx, Komuna xxx, xxxx, me shtetësi shqiptare, e martuar me x fëmijë, përfaqësuar në gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur prej saj avokat K. B., Avokat i Dhomës së

Avokatisë xxxx, me adresë selie Rruga “xxxx”, Lagjja Nr. x, banesa Nr. x, xxxx, i paisur me prokurën e posaçme Nr.xxxx Rep, Nr. xxxx Kol, datë xxxx.

PERSONA TË TRETË:

1) **A. M.**, i biri i G. dhe i N., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx dhe banues në xxxx, Lagjja Nr. x, Rruga “xxxx”, qendra administrative Nr.x xxxx, me shtetësi shqiptare, përfaqësuar gjatë gjykimit nga mbrojtësi i zgjedhur me deklaram në seancë Avokat I. D., Avokat i Dhomës së Avokatisë xxxx, me adresë selie: Lagjja “xxxx”, xxxx, i pajisur dhe me Prokurën Nr. xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx.

2) **H. M.**, i biri i S. dhe i Gj., i datëlindjes xxxx, lindur dhe banues në xxxx, lagjja “xxxx”, përfaqësuar gjatë gjykimit nga Avokat . D., i zgjedhur me deklaram në seancë, Avokat i Dhomës së Avokatisë xxxx, me adresë selie: Lagjja “xxxx”, xxxx.

3) **B. M.**, i biri i Q. dhe i B., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx dhe banues në Rruga “xxxx”, kilometri i x xxxx-xxxx-xxxx, përfaqësuar gjatë gjykimit nga Avokat I. D. i zgjedhur me deklaram në seancë, Avokat i Dhomës së Avokatisë xxxx, me adresë selie: Lagjja “xxxx”, xxxx.

4) **A. G.**, i biri i D. dhe i M., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx dhe banues në lagjen “xxxx”, Nr. xxxx, rruga “xxxx”, xxxx, i përfaqësuar gjatë gjykimit nga Avokat I. D. i zgjedhur me deklaram në seancë, Avokat i Dhomës së Avokatisë xxxx, me adresë selie: Lagjja “xxxx”, xxxx.

OBJEKTI:

1) Konfiskimin e pasurive të paluajtshme të sekuestruara me vendimin Nr. xx datë xxxx, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda si më poshtë:

- Objekti truall me numër pasurie me sipërfaqe parcele ndërtimore xxxx m², zona kadastrale xxxx, lagjja ”xxxx“-xxxx, me pronar Sh. B..

- Objekti ndërtesë x kate me sipërfaqe totale xxxx m², me numër pasurie xxxx, zona kadastrale xxxx, lagjja “xxxx” xxxx, i regjistruar në emër të Sh. B..

2) Për administrimin dhe përdorimin e pasurive të paluajtshme të ngarkohet Z.E. B., i cili është administrator i

Agjencisë për Administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

3) Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit xxxx.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar.

Gjykata, pasi administroi aktet në cilësinë e provës dhe mori konkluzionet përfundimtare në të cilat palët kërkuan:

Pala paditëse: Pranimin e kërkesës

Avokati K. B. për palën e paditur: Rrëzimin e kërkesës.

Avokati I. D. për personat e tretë: Rrëzimin e kërkesës

V Ë R E N

I. Rrethanat Procedurale

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka sjellë për gjykim kërkesën penale objekt shqyrtimi në ngarkim të të paditurit Sh. B., me objekt konfiskim pasurie.

Bazuar në nenin 7 të ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” ndryshuar me ligjin Nr.70/2017, gjykata është kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

Kjo çështje ka ardhur për rigjykim pasi me Vendimin nr. xx datë xxxx te Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është vendosur prishja e Vendimit nr.x datë xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për shkelje procedurale pasi nuk ishte thirrur në gjykim bashkëpronaria e pasurisë së të pasiturit, bashkëshortja e tij.

Në rigjykimin e kësaj çështje Gjykata, pasi njohu palët me përmbajtjen e vendimit Nr. xx datë xxxx të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, ku ndër të tjera përcaktohet se: “ Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se prona objekt konfiskimi është në emër të Sh. B.j, kjo sipas dokumentit leje legalizimi Nr.xxxx datë xxxx, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZN-it xxxx, por gjatë gjykimit sipas certifikatës familjare Nr.xxxx datë xxxx, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Komuna Qendër xxxx rezulton se Sh. B. është i martuar me shtetasen M. B. e cila për shkak të qenit bashkëshorte e të paditurit ka të drejtën e pronësisë për ½ e pasurisë,

*kjo në referim të nenit 231 të K.Familjes....., mospërfshirja e saj me cilësinë e palës së paditur kur ajo mbart të drejta dhe detyrime në lidhje me këtë prone objekt konfiskimi e bën të vesuar procesin e shkallës së parëpër mosformin të drejtë të ndërgjyqjesisë”, në referim të nenit 467 të K.Pr.Civile titulluar “Dërgimi për rigjykim” i cili përcakton se Gjykata e Shkallës së Parë në rigjykim është e detyruar ti përmbahet vendimit të Gjykatës së Apelit për çdo veprim procedural të vendosur, me vendim të ndërmjetëm në datë xxxx, **thërriti në këtë gjykim në cilësinë e të paditurës shtetasen M. B..***

Meqënëse çështja është në rigjykim dhe gjykimi i parë i saj është bërë referuar rregullimeve ligjore të mëparshme dhe rregullave të kodit të Procedurës Civile, edhe gjatë rigjykimit të saj Gjykata iu refruar këtyre rregullave sipas asaj çfarë parashikon dispozita kalimtare neni 38 i ligjit i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, neni 35 i tij.

Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” ndryshuar me ligjin Nr.70/2017, në nenin 38 të tij të titullar “Dispozitat kalimtare e ligjit Nr. 70/2017”, pika 1 e tij e cila përcakton se “Ky ligj zbatohet për kërkesat e marrjes së masave parandaluese të paraqitura nga prokurori në gjykatën kompetente pas hyrjes në fuqi të tij”.

Nga aktet e depozituara në gjykatë rezulton se kërkesa me objekt konfiskim pasurie ndaj të paditurit Sh. B., është paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nga pala paditëse në datë xxxx, për sa më sipër në çështjen objekt gjykimi në referim të nenit 38 të tij të titullar “Dispozitat kalimtare e ligjit Nr. 70/2017”, pika 1, në shqyrtimi i kësaj padie, gjykata do të respektojë përmbajtjen e ligjit Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” të pa ndryshuar me ligjin Nr.70/2017.

II. Faktet objekt kërkesë.

Kërkesa për konfiskim pasurie është bazuar në faktet juridike se në datë xxxx, në referim të neneve 287/1 dhe 315/3 të K.Pr.Penale, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx mbi kallëzimin penal Nr.xxx datë xxxx të referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut xxxx, Sektori Kundër Krimit Financiar, ka urdhëruar të kryhet regjistrimi i procedimit penal me Nr. xxx për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Sipas informacioneve të mblledhura nga Drejtoria e Policisë së Qarkut xxxx, ka rezultuar se shtetasit E. B. (i njohur dhe me gjeneralitetet B. B.j dhe E. M.), i biri Sh., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx dhe I. K. (I. B.), i biri i Sh., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx, kanë kryer investime në fushën e ndërtimit si dhe transaksione në shuma të konsiderueshme, të cilat dyshohen se janë produkt i aktivitetit kriminal të ushtruar prej tyre. Konkretisht, në bazë të informacionit mbi referimin e veprës penale datë xxxx, rezulton se shtetasit E. B. (B.j)

dhe i ndjeri vëllai i tij I.K. (*i cili ka gjetur vdekjen në muajin xxxxt të vitit xxxx*) kanë ndërtuar një godinë x-katëshe në lagjen "xxxx" xxxx, me destinacion xxxx. Nga informacioni policor i mbledhur rezulton se këta shtetas kanë ushtruar veprimtari kriminale në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike.

Referuar informacioneve të lartpërmendura, në kuadër të hetimeve të kryera nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx, është kërkuar informacion nga zyra ndërlidhëse e policisë Italiane në lidhje me procedimet penale në ngarkim të shtetasve E. B. dhe I. K..

Nga informacioni i marë nga Zyra Ndërlidhëse e Policisë Italiane Interforcë, është bërë me dije se shtetasi I. K. (B.) i njohur dhe si *alias I. B., alias S. S., alias I. B.*, është arrestuar në flagrancë në datë xxxx për trafikim të lëndëve narkotike dhe armëmbajtje pa leje. Më datë xxxx në ngarkim të shtetasit I. K. është lëshuar një mandat arresti për deklaram të rremë në lidhje me identitetin. Më datë xxxx ky shtetas është liruar nga burgu me anë të Urdhrit Nr.xxxx SIEP të datës xxxx të Prokurorisë së Republikës në xxxx. Në vijim, ndaj shtetasit I. K. është dhënë masa e sigurisë "*Arrest në burg*" Nr.xxxx e datës xxxx nga Gjykatësi i Hetimeve Paraprake pranë Gjykatës në xxxx në kuadër të procedimit penal Nr.xxx/xx xxxx për trafik lëndësh narkotike. Gjithashtu ndaj shtetasit I. K. më datë xxxx, është caktuar masa e sigurisë "*Arrest në burg*" në vijim të ekstradimit në Belgjikë.

Nga të dhënat e këtij hetimi ka rezultuar se dhe shtetasi E. B. (B.) ka qenë i proceduar nga autoritetet e drejtësisë në Holandë, ku ka qenë i arrestuar për vepra penale të kryera në fushën e narkotikëve.

Në vijim të hetimeve të kryera nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx, ka rezultuar se me lejen numër xxxx datë xxxx, shtetasi Sh. B., i ati i I. K. dhe E. B., është pajisur me leje legalizimi për objektin me numër pasurie xxxx, zona kadastrale xxxx me sipërfaqe parcele ndërtimore xxxx m², sipërfaqe totale ndërtimi xxxx m², numri i kateve mbi tokë x (xxxx). Me kontratën noteriale të kaparit Nr.xxxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx, shtetasi Sh. B., në cilësinë e blerësit rezulton të ketë blerë nga trashëgimtarët e Sh. G. këtë truall në vlerën xxxx (xxxx) Euro.

Në kuadër të hetimeve janë marë deklaram si persona që kanë dijeni për rrethanat e hetimit nga shtetasit Sh. B. dhe E. B. si dhe është kërkuar konfirmim nga institucionet shtetërore, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, drejtoritë e transportit rrugor etj, në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në zotërim të shtetaseve E. B. (B.), I. K. dhe familjarëve e tyre. Nga institucionet bankare që operojnë në vend është kërkuar informacion edhe në lidhje me transaksionet bankare të kryer nga këta shtetas.

Është proceduar gjatë hetimit nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx me kryerjen e një ekspertimi vlerësues të pasurisë godinë x-katëshe në lagjen "xxxx" xxxx dhe nga akti i ekspertimit vlerësues i kësaj pasurie konkludohet se vlera e objektit të vlerësuar sipas kostos

së ndërtimit për qytetin e xxxx, në momentin e inspektimit kur objekti nuk është përfunduar por është realizuar në 82.2 % të volumit të ndërtimit ka vlerën xxxx (xxxx) Lekë. Konstatohet se punimet brenda në godinë nuk kanë përfunduar. Po ashtu në vlerën e kostos nuk është përfshirë vlera e truallit.

Në vijim të hetimeve në datë xxxx, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx ka përcjellë një letërporosi autoriteteve italiane duke kërkuar ndihmën juridike në fushën penale në lidhje me procedimet penale dhe proceset gjyqësore të zhvilluar në Itali ndaj shtetasve E. B. (i njohur dhe me gjeneralitetet B. B. dhe E. M.) dhe I. K. (K., B., B.) si dhe verifikim nga instancat financiare të këtij shteti në lidhje me transfertat bankare të pjesëtareve të familjes B..

Referuar rezultateve të hetimeve në datë xxxx, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx është urdhëruar në regjistrimin e veprave penale Nr.xxx/xxxx për veprën penale të “Pastrimi të produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 i K.Penal të regjistrohet në regjistrimin e autorëve si person nën hetim shtetasi E. B..

Me vendimin Nr. xxx datë xxxx, Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx mbi kërkimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxxx ka vendosur sekuestron mbi pasurin truall me sipërfaqe parcele ndërtimore xxxx m², zona kadastrale xxxx, ndodhur në lagjen "xxxx" xxxx, me pronar Sh. B. dhe ndërtesë x (xxxx) kate me sipërfaqe xxxx m², me numër pasurie xx/xxx, zona kadastrale Nr. xxxx, ndodhur në lagjen "xxxx" xxxx e regjistruar në emër të shtetasit Sh. B..

Me shkresën Nr. xxxx datë xxxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë xxxx, ka dërguar në Prokurorinë për Krime të Rënda materialet e lartpërmendura me qëllim fillimin e procedimit pasuror në ngarkim të shtetasit E. B.. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pasi është njohur me materialin e venë në dispozicion duke vlerësuar se shtetasi E. B. është subjekt i hetimit pasuror sipas ligjit Nr.10191 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, sipas nenit 3/1/ç, bazuar në nenin 24/1 dhe 287/1 të K.Pr.Penale, ka vendosur në datë xxxx të regjistroj procedimin pasuror Nr. x të vitit xxxx në ngarkim të shtetasit E. B. (i njohur dhe me gjeneralitetet B. B. dhe E. M.).

Mbi kërkesën datë xxxx, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për vendosjen e masave parandaluese të sekuestrimit të pasurisë të shtetasit Sh. B., me vendimin Nr. xx datë xxxx Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur sekuestrimin e pasurive truall me numër pasurie me sipërfaqe parcele ndërtimore xxxx m² zona kadastrale xxxx, Lagjia "xxxx" xxxx, me pronar Sh. B. si dhe ndërtesë x (xxx) kate me sipërfaqe totale xxxx m², me

numër pasurie xxxx, zona kadastrale xxxx, lagjia "xxxx" xxxx, i regjistruar në emër të shtetasit Sh. B.. Ky sekuestrim është zgjatur për një periudhë x (xxx) mujore me vendimin Nr.xx datë xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Me shkresën datë xxxx, Ministria e Drejtësisë ka përcjellë pranë Prokurorisë së Përgjithshme dokumentacionin e autoriteteve Italiane mbi ekzekutimin e letërporosisë së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxxx në lidhje me procedimin penal Nr. xxx të vitit xxxx.

Në datë xxxx, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, pas kryerjes së hetimeve në lidhje me procedimin pasuror Nr. x, ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kërkesën për konfiskim pasurie kundër të paditurit Sh. B..

Në gjykimin në shkallë të parë nga ana e përfaqësuesit ligjor të palës së paditur është pretenduar se i padituri Sh. B., ka marrë një shumë të konsiderueshme huash nga persona të tretë, të ardhura të cilat janë përdorur për ndërtimin e ndërtesës objekt konfiskimi, për këtë arsye kjo palë ka kërkuar thërritjen në cilësinë e personave të trete të shtetasve A. M., A. G., H. M. dhe B. M.. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendim të ndërmjetëm, në referim të nenit 22 pika 3 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" i ndryshuar, në bazë edhe të nenit 193/1 të K.Pr.Civile, ka pranuar kërkesën për të thërritur me cilësinë e personave të tretë të shtetasve A. M., A. G., H. M. dhe B. M..

Në përfundim të gjykimit me vendimin Nr. xx datë xxxx, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur të pranojë padinë e Prokurorisë pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, duke konfiskuar dhe kaluar në pronësi të shtetit pasuritë e paluajtshme objekt tokë truall me sipërfaqe parcele ndërtimore xxxx m², zona kadastrale xxxx, dhe objekti ndërtese x-x (xxxx) kate plus objekt ndihmës x kat, plus x kate nën tokë, me sipërfaqe totale xxxx m², me numër pasurie xxxx, zona kadastrale xxxx, Lagjia "xxxx" xxxx, në emër të Sh. B..

Ndaj vendimit Nr.xx datë xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është ushtruar e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Me vendimin Nr.xx datë xxxx, pas marrjes në shqyrtim të ankimit Gjykata e Apelit për Krime të Rënda për shkak të mos formimit të drejtë të ndërgjyqësisë ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me trup tjetër gjykues.

III. Pretendimet e palëve dhe provat e marra në shqyrtim

3.1. Pretendimet dhe provat e palës paditëse, Prokurorisë për Krime të Rënda.

Në rigjykim pala paditëse pretendoj se referuar akteve të administruar nga autoritetet italiane të drejtësisë evidentohet ekzistenca e procedimeve penale dhe proceseve gjyqësore ndaj shtetasve E. (B.) B. dhe I. K. (I. B.). Për veprat penale të “Mbajtjes dhe transportimit të lëndëve narkotike” në bashkëpunim, “Pjesëmarrjes në organizata ndërkombëtare për trafikimin e lëndëve narkotike, mbajtjes dhe transportimit të lëndëve narkotike”, në bashkëpunim.

Të gjitha pasuri objekt konfiskimi dyshohet se janë fituar nga të ardhurat e realizuara si rezultat i veprimtarise kriminale të kryer jashtë shtetit nga personi i hetuar E. (B.) B. (i njohur dhe me gjeneralitetet B. B. dhe E. M.), i biri Sh., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx dhe i ndjeri vëllai i tij I. K. (I. B.), i biri i Sh., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx.

Lidhur me këto pasuri të sekuestruara pala paditëse pretendon se janë kushtet për konfiskimin e tyre sipas neneve 22 dhe 24 të ligjit Nr. 10192 date 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", pasi së pari ato janë perfituar pas përfshirjes së personave të hetuar E. B. *alias* B. B. dhe vëllai i tij i ndjeri I. K. *alias* I. B. në veprimtari kriminale, veprimtari kriminale që daton që në vitin 1994 për të ndjerin I. B. dhe në vitin 2004 për shtetasin E. B.. Së dyti, këto pasuri nuk i përgjigjen nivelit të të ardhurave të të dyshuarve dhe familjarëve të tyre. Së treti, pasuritë janë në zotërim të drejtëpërdrejtë të personave të hetuar të cilët pavaresisht faktit se dokumentat i kanë regjistruar në emër të babait të tyre Sh. B., nga deklaratimet e këtij të fundit rezulton se objekti i ndërtuar është fryt i investimeve të djemve të tij E. B. *alias* B. B. dhe i njeri I. K. *alias* I. B..

Për të mbështetur kërkesën për konfiskim, në funksion të provueshmërisë së saj u paraqitën si prova të ndodhura në dy volume këto akte procedurale:

i. Vendim Nr. xx datë xxxx i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nga e cili u përftua e dhëna se gjykata bazuar në nenet 3, 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", ka vendosur sekuestrimin e pasurive të paluajtshme, objekt truall me nr. pasurie me sipërfaqe parcele ndërtimore xxxx m² zona kadastrale xxx, lagjia "xxxx" xxxx, me pronar Sh. B. si dhe objekt ndërtese x kate me sipërfaqe totale xxxx me numër pasurie xxxx zona kadastrale xxxx, lagjia "xxxx" xxxx, i regjistruar në emër të shtetasit Sh. B..

ii. Shkresë Nr. xxxx Prot xx, datë xxxx, nga e cila u përftua e dhëna se në përgjigje të kërkesës për Ndhimë Juridike lidhur me Procedimin penal xxxx (kërkuar nga Prokuroria e Rrethit xxxx), nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiskionale me Jashtë, është përcjellë letërporosia e autoriteteve Italiane të Drejtësisë, për në Prokurorinë e Përgjithshme, për t'i përcjellë ato në drejtim të Prokurorisë së xxxx, duke theksuar se

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka regjistruar procedimin pasuror Nr.x të vitit xxxx. Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë në prokuroritë përkatëse materialet e letërporosisë së autoritete Italiane të Drejtësisë, materialet lidhur me procedimet penale dhe vendimet Gjyqësore ndaj E. B., i datëlindjes xxxx, alias B. B., alias E. M. lindur në xxxx, dhe I. K., alias K., B., B., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxxx, alias S. S., i datëlindjes xxxx (Jugosllavi (Serbi-Mali i Zi). Në këto akte të letërporosisë përfshihen çertifikatat e regjistrit gjyqësor për shtetasit I. K., E. B., si dhe vendimet Nr.xxx/xx, i datës xxxx, i shpallur nga Gjykata e Apelit e xxxx, në ngarkim të I. B.-, i datelindjes xxxx, i lindur në xxxx (Shqipëri), Vendim Nr.xxxx, i datës xxxx, i shpallur nga Gjykata e Apelit e Milano-s, në ngarkim të S. S., i datëlindjes xxxx, i lindur ne xxxx (xxxx), vendim Nr.xx datë xxxx i shpallur nga Gjykata e Apelit e xxxx, në ngarkim të B. B., i datëlindjes xxxx, i lindur në xxxx (Shqipëri).

iii. Shresë Nr.xxxx Prot datë xxxx, nga e cila u përftua e dhëna në lidhje me transfertat bankare të kryera nëpërmjet xxxx nga shtetasit n Sh., M., I., E. B. etj.

iv. Shkresë Nr. xxx Prot datë xxxx, nga e cila u përftua e dhëna se shtetasit Sh. B. dhe M. B., nuk kanë llogari dhe nuk kanë kryer transaksione pranë xxxx. Shtetasi I. B., rezulton të ketë kryer disa transfertat (x të tilla) për aq sa ka gjeneruar sistemi për vitet xxxx-xxxx. Shtetasit I. K., E. B. dhe E. M. nuk kanë llogari dhe nuk kanë kryer transaksione pranë këtij instituti. Shtetasi E. B. ka kryer x transfertat (të transferuara nga jashtë), sipas asaj që ka gjeneruar sistemi. Shtetasja R. B., një transfertë bankare, ndërsa shtetasja E. B., nuk ka llogari dhe nuk ka kryer transfertat bankare pranë xxxx.

v. Shkresë Nr.xxxx Prot, datë xxxx e xxxx Bank, nga e cila u përftua e dhëna se shtetasi Sh. S. B., ka llogari bankare pranë kësaj Banke. Ky shtetas rezulton se nuk ka marrë kredi pranë kësaj banke, shkresa ka të bashkangjitur informacionin bankar për këtë llogari.

vi. Shkresë Nr.xxxx Prot, datë xxxx, e xxxx Bank, nga e cila u përftua e dhëna se shtetasi I. K., ka llogari bankare pranë kësaj banke. Shkresa ka të bashkangjitur informacionin bankar për këtë llogari.

vii. ShkresëNr.xxxx Prot, datë xxxx e Banka xxxx, nga e cila u përftua e dhëna se shtetasi Sh. S. B., ka llogari bankare pranë kësaj banke, duke theksuar se ka disa llogari bankare në euro dhe lekë. Shkresa ka të bashkangjitur informacionin bankar për këtë llogari.

viii. Shkresë Nr.xxxx Prot, datë xxxx e xxxx Bank, nga e cila u përftua e dhëna

se shtetasit E. E. B. dhe B. E. B., janë klientë të kësaj banke, kanë depozita kursimi “Për fëmijë”, me gjendje në llogari prej nga xxxx Euro (secili). Shkresa ka të bashkangjitur informacionin bankar për këtë llogari.

ix. Shkresë Nr.xxxx Prot, datë xxxx e xxxxx, nga e cila u përftua e dhëna se shtetasi I. I. K., ka depozitë pa afat deri në 18 vjeç pranë kësaj banke. Shkresa ka të bashkangjitur informacionin bankar për këtë llogari.

x. Shkresë Nr.xxxx, datë xxxx e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve xxxx, nga e cila u përftua e dhëna se pjesëtarë të familjes xxxx, nuk figurojnë të regjistruar si tatimpagues në drejtorinë rajonale, shtetasi I. Sh. B., nuk figuron si tatimpagues pranë kësaj drejtorie.

xi. Shkresë Nr.xxxx Prot, datë xxxx e Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave Departamenti Operativ Hetimor, nga e cila u përftua e dhëna se shtetasit Sh. B.j, I. K. (I. B.), E. B. (B. B./E. M.) dhe anëtarë të tjerë të familjes B.j), pas verifikimit në bazën e të dhënave, rezulton se nuk kanë deklaruar para CASH, çek, apo metale e sende çmuara në pikat e kalimit kufitar...përsa i përket import- eksportit...sistemi ynnë kërkon detyrimisht numrin e Identifikimit të personit të tatushëm, NIPT-in”.

xii. Shkresë Nr.xxxx, datë xxxx e Drejtorisë së Përgjithshme së Shërbimit të Transportit Rrugor, nga e cila u përftua e dhëna se nga verifikimet në arkivën Kombëtare elektronike të mjeteve shtetasi E. Sh. B. ka në pronësi automjetin me targë xxxx. Bashkangjitur ndodhet dokumentacioni i këtij mjeti.

xiii. Shkresë Nr.xxxx, datë xxxx e Qendrës Kombëtare e Rregjistrimit QKR, nga e cila u përftua e dhëna se nga verifikimi i kryer mbi bazën e emrit, rezulton se shtetasi I. K., i datëlindjes xxxx, figuron të jetë si përfaqësues ligjor dhe ortak në shoqërinë xxxx, me NIPT xxxx, bashkalidhur ndodhet ekstrakti i këtij subjekti.

xiv. Shkresë Nr. xxxx, datë xxxx e Qendrës Kombëtare të Liçensimit nga e cila u përftua e dhëna se pas verifikimit të Rregjistrimit Kombëtar të Liçencave dhe Lejeve, rezulton se përsa i përket listës së personave që është kërkuar (personat e familjes B. shtetasit Sh. B., E. B. (B. B./E. M.), I. K. (dhe anëtarë të tjerë të familjes B.), nuk kanë aplikuar në sportelet e QKL-së, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, personit fizik ose personit të autotizuar për t’u pajisur me liçencë apo leje.

xv. Shkresa të Zyrave Vendore të Pasurive të paluajtshme, nga të cilat është përftuar e dhëna se shtetasit Sh., E., R., E., B., I. dhe I. K., nuk kanë të rregjistruar pasuri të Paluajtshme të rregjistruar në Tirnaë, Vlorë, Korçë, Gramsh, Pogradec, Krujë, Berat, Gjirokastër, Tropojë, Pukë, Mirditë, Mat, Kuovë, Peqin, Librazhd, Kukës, Fier,

Devoll, Bulqizë, Kolonjë, Dibër, Skrapar, Lezhë, Durrës, Kavajë, Kurbinë, Shkodër, Mallakastër, Has.

xviii. Procesverbal për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave datë xxxx, nga nga i cili u përftua e dhëna se janë marrë në cilësinë e dokumentave kërkesa Nr.xxx datë xxxx, Leje Legalizimi Nr. xxxx datë xxxx, për objektin godinë shërbimi x-x katëshe me restorant x katë, plus objekt ndihmës x katë, në emër të Sh. S. B., për pasurinë Nr.xxxx, Zona Kadastrale xxxx, me sipërfaqe ndërtimore xxxx (xxxx) m², me sipërfaqe ndërtimi xxxx (xxxx), me kufizimet përkatëse bashkangjitur kartela e pasurisë së paluajtshme e legalizuar për pasurinë me Nr.xxxx, me kondicionet përkatëse, me datë regjistrimi xxxx, në emër të shtetasit Sh. S. B.; bashkangjitur shkresa Nr.xxxx Prot, datë xxxx, e Agjencisë së Legalizimit U.I.Z.N.I Drejtoria xxxx, drejtuar ZVRPP xxxx; bashkangjitur Gentplani për pasurinë Nr.xxxx, në emër të poseduesit Sh. S. B., bashkangjitur kopje “Kontratë Kapari” Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, lidhur ndërmjet F. I. M., trashëgimtarët e Sh. G. dhe Sh. S. B.. Sipas “Kontratë Kapari” Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, blerësi Sh. B. do të blejë sipërfaqe totale prej xxxx m², regjistruar në ZVRPP xxxx, në zonën kadastrale xxxx, lagjen “xxxx” xxxx, kundrejt një çmimi prej xxxx (xxxx) euro, ku theksohet se blerësi ka paguar ditën e nënshkrimit të kontratës xxxx (xxxx) Euro dhe xxxx (xxxx) Euro do paguhen deri më datë xxxx, sipas kondicioneve të kësaj kontrate; bashkangjitur kopje nga “Vërtetim të dokumentit Hipotekor” Nr.xxx, datë xxxx, në emër të Sh. G. dhe F. A., bashkangjitur Plan rievimi për këtë pronë, bashkangjitur kopje Vendimi Nr.xx, datë xxxx, i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe plan vendosja e pronës.

Bashkë me aktet e më sipër ndodhet dhe kopje e Deklaratës Noteriale Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, sipas të cilës, shtetasit F. M., P. G., etj, deklarojnë se më datë xxxx, kanë lidhur kontratën Kapari me Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, me palën blerëse Z.Sh. S. B.. *Deklarojmë se pala blerëse e ardhshme Z.Sh. S. B., nuk ka më detyrime të pashlyera kundrejt nesh në lidhje me çmimin e kësaj kontrate....çmimi i shitjes është shlyer tërësisht...”*.

xiv. Shkresë Nr.xxxx Prot, datë xxxx e Agjencisë së legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Ndërtimore Informale, nga e cila u përftua e dhëna se është vënë në dispozicion të Prokurorisë xxxx kopje e njësuar me origjinalin e dosjes së legalizimit në lidhje me Lejen e Legalizimit Nr.xxxx, datë xxxx, dhënë shtetasit Sh. S. B.. Në këto dokumenta përfshihen kërkesë për legalizimin e ndërtimit pa leje bërë nga Sh. S. B. datë xxxx kopje e çertifikatës familjare, “Vërtetim nga dokumenti hipotekor”, Nr.xxx, datë xxxx, në emër të Sh. B., deklaratë për zbatimin e planit rregullues.

xv. Procesverbal i këqyrjes së vendit të ngjarjes datë xxxx, nga i cili u përftua e dhëna në lidhje lidhje me rezultatet e këqyrjes së objektit ndodhur në lagjen “xxxx” në anën

perëndimore të hotel “xxxx”. Në këtë akt përcaktohen vendodhja e tij, kufizimet etj., bashkangjitur ndodhen dhe tabelat fotografike të ndërtesës.

xi Akt *ekspertimi vlerësues datë xxxx*, nga i cili u përftua e dhëna në lidhje me vlerësimin e objektit me Nr. xxxx pasurie, zona kadastrale xxxx.

xvii *Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale datë xxxx*, nga i cili u përftua e dhëna se shtetasi Sh. B. i pyetur nga organi i Prokurorisë xxxx, në lidhje me pasurinë Nr. xxxx pasurie, zona kadastrale xxxx ka deklaruar se kjo pasuri është investim i të afërmeve të tij, konkretisht djemve të tij A. B., E. B. dhe I. K. që nuk jeton më, ku secili ka vendosur të ardhura. Burime të këtyre të ardhurave janë siguruar nga shitja e bagëtive të imëta që Sh. B. ka patur për periudhën 1990-2006, si dhe të ardhurat e fituara nga puna në emigrim e djemve të tij që në vitet '90. Lidhur me truallin ku është ndërtuar objekti, ai shpjegon se djali i tij I. K. e ka blerë nga M. G.. Me sa ka dijeni nga i ndjeri I. K., vlera e objektit ka shkuar rreth xxxx (xxxx) Lekë. Ai shpjegon se në muajin Dhjetor të vitit 2014 është pajisur me certifikatë pronësie për këtë objekt. Po ashtu shpjegon, se në vitet 2007-2008 djali i tij I. ka qenë në burg në Belgjikë ose Hollandë për rreth dy vjet.

xviii *Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale datë xxxx*, nga i cili u përftua e dhëna se shtetasi Sh. B. i pyetur nga organi i Prokurorisë xxxx në lidhje me pasurinë Nr. xxxx pasurie, zona kadastrale xxxx, theson se kjo pasuria është produkt i të ardhurave familjare, me objektit është marrë më tepër vëllai i tij I. dhe me sa ka ai dijeni vlera e objektit ka shkuar rreth xxxx (xxxx) Lekë të vjetër. Ai shpjegon se që nga viti 1999 ka punuar si emigrant në Itali. Në Shqipëri ka patur një depozitë në vlerën xxxx (xxxx) Euro në xxxx Bank. Nuk ka qenë i punësuar në Shqipëri, por të ardhurat i ka siguruar nga puna e tij jashtë shtetit. Ai është arrestuar në Hollandë në vitin 2001, ku ka bërë 6 muaj burg, po ashtu edhe vëllezërit e tij kanë qenë të arrestuar jashtë shtetit.

xix *Certifikatë Familjare datë xxxx*, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Qëndër- xxxx, nga e cila u përftua e dhëna se shtetasi E. B. i datëlindjes xxxx, i biri i Sh. dhe i M., sipas shënimit në këtë certifikatë, shtetasi B. B. ka bërë ndërrim emri dhe mbiemri me procesverbalin Nr.xx datë xxxx në E. M. dhe me procesverbalin Nr.xx datë xxxx, ka ndërruar mbiemrin në B., ky shtetas tani figuron në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile me gjeneralitete E. B., fakt i cili rezulton nga vërtetimi lëshuar nga Komuna Qëndër xxxx, Zyra e Gjendjes Civile datë xxxx.

xx *Certifikatë personale datë xxxx*, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Komuna Qendër, nga e cila u përftua e dhëna se shtetasi I. K., i datëlindjes xxxx, i biri i Sh. dhe i M., lindur në xxxx, me vendim të Komunës Qendër Nr.xxxx,

datë xxxx, ka bërë ndërrim të mbiemrit nga B. në K. dhe sipas çertifikatë së vdekjes Nr.xxxx serie, datë xxxx, rezulton se shtetasi I. K., ka vdekur me datë xxxx.

Sipas Akteve të Letërporosisë ndër të tjera rezulton: se B. B., i datëlindjes xxxx:

- i) *Në datë xxxx, vendimi i Gjykatës së Apelit xxxx, ka marrë formë të prerë në datën xxxx, për veprën penale: Blerje dhe dhënie e paligjshme lëndësh narkotike në vazhdimësi dhe në bashkëpunim sikurse parashikohet nga nenet 81, 110, të Kodit Penal....të kryer në datën xxxx, në xxxx;*
- i) *...në datën xxxx, vendimi i Gjykatës së Apelit xxxx, ka marrë formë të prerë në datën xxxx, për veprën penale:Pjesmarrje në organizatë me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike sikurse parashikohet nga neni 74 paragrafi 2 i dekretit të Presidentit të Republikës...kryer në vitin 2008. Për veprën penale: Importim dhe mbajtje e lëndëve narkotike në bashkëpunim ...të kryer nga datat xxxx dhe deri me datë xxxx, në Romë dhe Belgjikë. Për veprën penale: Importim dhe mbajtje e lëndëve narkotike në bashkëpunim ...të kryer nga datat xxxx në Firence, në Belgjikë, dhe San Giovanni Valdarno. Për veprën penale: Kalim i paligjshme e lëndëve narkotike në bashkëpunim ...të kryer nga datat xxxx, San Giovanni Valdarno.*

Si dhe xxxx, vendimi i Gjykatës së Apelit të Firences që ka marrë formë të prerë në datë xxxx, vepra penale pjesmarrje në organizatë me qëllim trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike...kryer në vitin 2008.

Në ngarkim të shtetasit I. B., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx;

- i) *Në datën xxxx, vendimi i Gjykatës së Apelit të Milanos ka marrë formë të prerë në datën xxxx. për veprën penale: Nxitje e prostitucionit, sikurse parashikohet nga neni 3, nr.50 i ligjit të datës 20.02.1958...kryer në vitin 1994.
.....(këtu përfshihen edhe kryerja e një sërë veprash penale por jo nga ato të parashikuara nga neni 3 i ligjit 10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar, për këtë arsye nuk po citohen).
Në datë xxxx, vendimi i Gjykatës së Apelit të Lece-s, ka marrë formë të prerë në datën xxxx, për veprën penale: Mbajtje dhe transport i lëndëve narkotike në bashkëpunim....të kryer me datë xxxx më Otranto....*

Në emër të S. S., i datëlindjes xxxx, i dënuar me vendim të formës së prerë (por për vepra penale që nuk përfshihen në fushëzbatimin e nenit 3 të ligjit 10192, datë 03.12.2009).

Bashkangjitur sa më sipër, janë edhe disa nga vendimet e dënimit, si dhe informacion mbi transferimet e parave të dërguarara nga E. B. nëpërmjet bankës “xxxx”, në drejtim të Shqipërisë dhe Greqisë.

Ndër të tjera, në vendimin Nr.xxxx, datë xxxx, Gjykatë e Apelit të xxxx, ka ndryshuar vendimin e Gjyqtarit të Hetimit Paraprak (ku I. B. ishte dënuar me x (xxxx) vjet e x , xxxx muaj burgim dhe xxxx (xxxx) euro gjobë për veprën penale të kryer në Otranto në datë xxxx, duke e dënuar atë përfundimisht me x (xxx) vjet dhe x (xx) muaj burgim dhe xxxx euro gjobë.

Në këtë vendim theksohet se: I. B. së bashku me shtetasit A.M dhe I. M, në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me persona të panjohur, kanë transportuar dhe sidoqoftë kanë mbajtur në mënyrë të paligjshme një sasi prej xxx (xxxx) kilogram lëndë narkotike e llojit marijuanë, të ndarë në x pako...”

Ndërsa sipas vendimit Nr.xxxx, datë xxxx, i Gjykatës së Apelit xxxx ndër të tjera rezulton (i dënuar me x vjet burgim nga shkalla e parë vendim i lënë në fuqi nga Apeli) *...e të pandehurit B. B.j (datëlindjes xxxx), në lidhje me krijimin sikurse nga nënkreu xxx, importimi nga Belgjika për në Itali i një sasi prej x (xx) kilogramësh kokainë e cila i ishte dhënë nga anëtarët e tjerë të organizatës, që ai ua kishte dorëzuar më pas marrësve përfundimtarë në Romë në datë xxxx, duke marrë pjesë në këtë sjellje edhe si mbledhës i parave që janë produkt i krimit...”*

Duke qenë se për personat e mësipërm, kishte të dhëna se ishin të përfshirë në kohë të ndryshme (nga vitit 1994 e në vijim 2012), në veprimtari kriminale në shtete të ndryshme, dhe se ata kishin investuar në pasuri të paluajshme në xxxx (regjistruar në emrin e babait të tyre Sh. B.), me të ardhura që dyshoheshin nga veprimtaria kriminale, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, ka marrë informacion dhe ka kryer hetime mbi veprimtarinë ekonomike dhe mënyrën e krijimit të të ardhurave, të cilat ishin investuar në pasuri të paluajtshme objekt konfiskimi.

Nga të dhënat e siguruara ka rezultuar se, shtetasi I. B., i datelindjes xxxx i lindur ne xxxx – Shqipëri, në datën xxxx, vendimi i Gjykatës së Apelit të xxxx - ka marrë formë të prerë në datën xxxx, për veprën penale: Nxitje e prostitucionit, sikurse parashikohet nga neni 3, nr. 50, i Ligjit të vitit 1958. Nr 75, të kryer në vitin 1994; Në datën xxxx, vendimi i Gjykatës së Apelit të xxxx, ka marrë formë të prerë në datën xxxx, për veprën penale: Braktisje e të miturve, në bashkëpunim, sikurse parashikohet nga nenet 110, 591, të Kodit Penal të kryer në datën xxxx, në xxxx; Në datën xxxx, vendimi i Gjykatës së Apelit të xxxx - ka marrë formë të prerë në datën xxxx, për veprën penale: Deklarim i rreme në lidhje me identitetin e vet përballë një funksionari publik, sikurse parashikohet nga neni 495 i Kodit Penal, të kryer në datën xxxx, në xxxx; Në datën xxxx, vendimi i Gjykatës së xxxx me Trup Gjykues të përbërë nga një Gjyqtar i vetëm - ka marrë formë të prerë në datën xxxx, për veprën penale: Deklarim i rreme në lidhje me identitetin e vet përballë një funksionari publik, sikurse parashikohet nga neni 495 i Kodit Penal, të kryer në muajin Nëntor 1997, në xxxx; Në datën xxxx, vendimi i Gjykatës së xxxx me Trup Gjykues të përbërë nga një Gjyqtar i vetëm - ka marrë formë të prerë në datën xxxx, për veprën

penale: Kërcënim, në bashkëpunim, sikurse parashikohet nga nenet 110, 612 të Kodit Penal, të kryer në datën xxxx, në Cremona; Në datën xxxx, vendimi i Gjykatës së Apelit të Lecce-s - ka marrë formë të prerë në datën xxxx, për veprën penale: Mbajtje dhe transport i lëndëve narkotike, në bashkëpunim, sikurse parashikohet nga neni 110 i Kodit Penal, neni 73 i Dekretit të Presidentit të Republikës, të datës xxxx, nr.xxx, të kryer në datën xxxx, në Otranto; Për veprën penale: Armëmbajtje pa leje, në bashkëpunim, sikurse parashikohet nga neni 110 i Kodit Penal, neni 2 i Ligjit të datës 02/10/1967, nr.xxx, të kryer në datën xxxx, në Otranto.

Prokuroria (pala paditëse në rastin në gjykim që përfaqëson interesat e shtetit), si në kërkesën për gjykim ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje (por edhe në konkluzionet përfundimtare), mbajti qëndrimin se: Procedimi Pasuror është regjistruar mbi bazën e materialeve të dërguara nga Prokuroria xxxx me shkresën Nr.xxxx prot, datë xxxx, ku bëhej fjalë që Prokurori Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx ka nisur procedimin penal Nr.xxx të vitit 2014, për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal. Kjo mbi bazën e materialeve të Drejtorisë së Policisë së Qarkut xxxx, se shtetasi E. B. i njohur me disa emra, dhe vëllai i tij i ndjeri I. K. (edhe ky i njohur me disa emra cituar sa më lart), kishin kryer investime të shumta dhe transaksione me vlera të mëdha financiare, dhe se kishte dyshime se këto të ardhura kishin burimin nga veprimtaria kriminale.

Prokurori argumenton faktin se këta persona nuk kishin të ardhura që të justifikonin shpenzimet (madje shpenzimet tejkalonin disa herë të ardhurat), nuk kishin aktivitet ekonomik dhe se personat sa më sipër ishin përfshirë në aktivitet kriminal disa vite më parë në shtete të ndryshme.

Sipas organit të akuzës, të ardhurat e tyre këta shtetas i kishin investuar në emër të babait të tyre (për t’i kamufluar), dhe se kishin blerë truallin dhe kishin ndërtuar një resort turistik godinë xxxx katëshe në Lagjen xxxx, dhe se shumat ishin të konsiderueshme.

Nga ana e Prokurorit renditen një sërë veprimesh hetimore. Argumentohet se Sh. B. është subjekt i këtij ligji si i afërm i personave të përfshirë në aktivitet kriminal.

Argumentohet se pasuritë e vëna janë në fushë zbatimin e ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar.

Gjithashtu argumentohet se këto pasuri nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave të të paditurit dhe as familjarëve të tij.

Evidentohet se këto pasuri i janë nënshtruar sekuestrimit ku Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin Nr.xx. datë xxxx, ka vendosur sekuestrimin e pasurive sa më sipër (ku edhe është bërë zgjatje e afatit të sekuestrimit).

3.2. Pretendimet dhe provat e palës së paditur.

Përfaqësuesi i palës së paditur avokat K. B., pretendoi se objekti i cili

pretendohet të konfiskohe nga ana e Prokurorisë është një objekt i ndërtuar mbi bazën e të ardhurave të krijuara nga familjaret e familjes B. në Shqipëri dhe pjesëtarë të tjerë të familjes rezidente në shtetin italian prej shumë vitesh. Kjo pronë është e regjistruar në emër të të paditurit Sh. B. thjesht si kryefamiljar dhe për të ruajtur unitetin dhe harmoninë në familje. Një pjesë e mirë e këtij ndërtimi është realizuar nëpërmjet huamarrjeve tek subjekte të tjerë që janë thirrur si persona të tretë në këtë gjykim, shumica e huasë së marrë kap vlerën xxx (xxxx) Euro. Pjesëtarë të familjes B. si shtetasit B. B., G. B.j, A. B., L. B., kanë qenë të punësuar në shtetin Italian duke siguruar të ardhura të cilat kapin një vlerë të konsiderueshme.

Për të mbështetur pretendimet e tyre në gjykim, në funksion të provueshmërisë së saj u paraqitën si prova të ndodhura nga përfaqësuesi i të paditurve këto akte procedurale:

i. Deklaratë Noteriale Nr.xxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx përpiluar midis shtetasve A. G. dhe Sh. B.. Në këtë deklaratë ndër të tjera pasqyrohet se: “...Sh. B. deklaroj nën përgjegjësinë time ...i ndjeri djali im I. B. ka marrë prej Z.A. G.j, që prej muajit Janar të vitit 2013 shumën prej xxxx (xxxx) Euro, me një interes vjetor prej 8% në vit, për ndërtimin e një hoteli i cili ndodhet në L.xxxx, që familja ime ka ndërtuar.unë si baba i tij marr përsipër detyrimin për të garantuar huadhënësin se detyrimi i të ndjerit djalit tim do të kthehet bashkë me interesat ashtu siç e kishim parashikuar në marrëveshjen e tyre..”.

ii. Deklaratë Noteriale Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, përpiluar midis shtetasve H.M. dhe Sh. B.. Në këtë deklaratë ndër të tjera pasqyrohet se: “...Sh. B.j, deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore ...se i ndjeri djali im I. B. ka marrë prej të afërmit të nuses së djalit tjetër (R. B.), Z.H. M. që prej muajit Tetor 2012 shumën prej xxxx (xxxx) Euro, me një interes prej 5% në vit për ndërtimin e një Hoteli të ndërtuar në L.xxxx. Këtë fakt e kam marrë vesh para një muaji. Për shkak të kësaj lidhje familjare djali im nuk kishte lidhur kontratë huaje me H. M. ...e njoh detyrimin e mësipërm kundrejt huadhënësit i cili na ka ndihmuar familjarisht në një moment që kishim nevojë....në kushtet kur djali im I. B. ka ndërtuar jetë pranohet dhe njihet prej meje për të garantuar huadhënësin se detyrimi do të kthehet bashkë me interesat...”.

iii. Deklaratë Noteriale Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, përpiluar ndërmjet A. M. dhe Sh. B.. Në këtë deklaratë ndër të tjera klarat pasqyrohet: “...konfirmoj unë Sh. B. marrjen nga djali im i ndjerë I. B.j (K.), i biri i Sh. dhe i M., dtl.xxxx, lindur në xxxx, të një shume prej xxxx (xxxx) euro me datë xxxx në Shqipëri, me interes xxxx euro në muaj Zotit A. M.. Nga xxxx deri në Gusht 2014, janë dorëzuar interesat mujore prej xxxx Euro z.A. M.. Nga Gushti 2014, nuk ka marrë interesa Z.A. M.....Me sigurimin e shumës xxxx Euro dhe kthimin e saj, pushojnë dhe interesat të cilat duhet të likujdohen

atij deri në momentin e kthimit të shumës hua...”.

iv. Deklaratë Noteriale Nr.xxxx rep, Nr.xxxx Kol, date xxxx, përpiluar midis shtetasve Sh. B. dhe B. M.a, ku ndër të tjera në këtë deklaratë pasqyrohet se: *“Sh. B.j nën përgjegjësinë time ligjore deklaroj se djali im i ndjeri I. B. ka marrë prej Z.B. M. në muajin Mars të vitit 2011 shumën prej xxxx (xxxx) Euro, në muajin Qershor të vitit 2011, shumën prej xxxx (xxxx) Euro, dhe në muajin Shkurt 2012, shumën prej shumën prej xxxx (xxxx) Euro, në total prej xxxx (xxxx) Euro me një interes prej 2% në vit për ndërtimin e një hoteli në Lagjen xxxx që Famija ka ndërtuar. Edhe pse më huadhënësin e djalit tim kemi pasur marrëdhënie mirëkuptimi, sot në kushtet kur djali im ka ndërtuar jetë deklaroj faktin e sipërpërmendur për njohjen e këtij detyrimi nga ana ime ...”.*

v. Çertifikatë familjarë, datë xxxx, nga e cila u përftua e dhëna se referaur Rregjistrin Themeltar të vitit 1974, Nr.serie xxxx, lëshuar me datë xxxx, nga ZGJ.Civile Komuna Qendër, në përbërjen familjare të shtetasit Sh. B. përfshihen shtetasit: M. B. bashkëshortja, A. B., A. B., I.-B., B. B. (të bijtë) A. B. (e bija).

Nga ana e pales së paditur u kërkua për tu marrë nga gjykata në cilësinë e provës deklaratat e të ardhurave të krijuara nga pjesëtarë të familjes B. në shtetin Italian për vitin 2002, 2003, 2006, 2007, 2008, 2016 të shtetasve shtetasit B. B., G. B., A. B., L. B..

Gjykata pasi u njoh me përmbajtjen e këtyre deklaratave konkludoi se dokumentat e paraqitur nuk plotësonin kushtet për t’u vlerësuar si prova, pasi ato nuk ishin marrë në formën e kërkuar nga ligji, pasi asnjë nga dokumentat e paraqitur nuk kishin vulën “Apostile” apo vulën zyrtare të Institucionit përkatës që ka detyrimin për lëshimin e tyre, në përputhje me dispozitat e e parashikuara në Konventën e Hagës e datës 05.11.1961 (neni 3 dhe 4 i Konventës).

Pavarësisht rrëzimit për marrjen në cilësinë e provës të këtyre dokumentave gjykata i njohu të drejtën pales që në çdo kohë të paraqitste dokumentat në formë e kërkuar nga ligjin.

Gjykata pranoi kërkesën e pales së paditur dhe personave të tretë për kryerjen e një riekspertimi vlerësues dhe kontabël.

Pala e paditur nëpërmjet përfaqësuesve ligjorë të tij parashitri gjatë hetimit gjyqësor dhe në konkluzione përfundimtare këto prapësime:

-Rasti në gjykim ishte i veçantë, sui generis dhe nuk jemi para një padie të mirëfilltë civile, ku ndonësë jemi trajtuar si të paditur, jemi para një procesi ku nuk ka paditës, dhe në këto kushte nuk kemi patur mundësi për të bërë kundra-padi.

-Lidhur me themelin, sipas kësaj pale detyrimi që i padituri ka ndaj kreditorëve shkon

në xxxx (xxxx) euro, ose xxxx (xxxx) lekë, ku sipas deklaratave noteriale (aktet noteriale janë të pasqyruara hollësisht tek provat shkresore): xxxx (xxxxx) euro, i ndjeri I. K. ja kishte marrë hua A. M., borxh i njohur nga babai i tij i padituri Sh. B.;

xxxx (xxxx) euro marrë hua H. M. nga I. K., borxh i njohur nga i padituri;

xxxx (xxxx) euro marrë hua nga I. B. (K.) tek A. G., borxh i njohur nga i padituri;

xxxx (xxxx) euro hua e marrë nga I.B. tek B. M., borxh i njohur nga i padituri.

Në kushte të tilla sipas palës së paditur, konform nenit 423 dhe 425 të K.Civil, jemi para një detyrimi solidar, dhe se Prokuroria nuk e ka konsideruar nga pikpamja civile këtë çeshtje, ku ky qëndrim vjen në kundërshtim me nenin 22 pika 5 i ligjit 10192, datë 03.12.2009. Kjo sepse nuk ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së këtyre veprimeve juridike të detyrimeve solidare civile.

Në këto kushte, fakti që nuk bëhet një kërkesë e tillë provon indirekt se nuk ka asnjë provë për të provuar pavlefshmërinë e detyrimeve solidare civile. Për pasojë duke qenë se nuk mund të konstatohen si të pavlefshme veprimet juridike në lidhje me huadhënien në këtë proces, Gjykata duhet të zhbllokojë sendin e të paditurit, ku i padituri ose të pranojë bashkëpronësinë në këtë send, ose të nxierë në shitje sendin për të shlyer detyrimet. Gjykata duhet të trajtojë këtë rast në frymën e K.Civil, dhe çdo ligj tjetër duhet t'i nënshtrohet frymës së K.Civil. Organi i akuzës ka bërë një kërkesë, por nuk ka marrë parasysh kontributin që kanë dhënë personat në ndërtimin e këtij sendi objekt konfiskimi.

Në të njëjtin moment procedural janë edhe palët e treta. Duke qenë se është njohur marrëdhënia e detyrimit ndaj palëve të treta si detyrim solidar, gjykata duhet të çlirojë sendin nga konfiskimi. Duke patur parasysh se xxxx euro janë kontribut i personave të tretë në këtë gjykim, duke patur parasysh se xxxx euro janë kontribur i të padituri dhe familjarëve të tij, si dhe trulli gjithashtu vlera e sendit kalon shumë prej xxxx mijë lekë, vlerësimi i ekspertës për sendin objekt konfiskimi është në shumën xxxx lekë, dhe se diferenca është puna e papaguar me të cilën është deklaruar dhe provuar në këtë proces që kanë bërë personat e njohur si dhe familjarët e tyre të familjes B..

Gjithashtu sipas palës së paditur, gjykata duhet të ketë parasysh edhe faktin që kreditimi i dhënë nga personat e tretë është dhënë me një qëllim të caktuar, ndërtimi i hotelit që është objekt konflikti në proces, dhe nëse në mënyrë të padrejtë do t'i konfiskohej të paditurit, atëherë ai di të detyrohej me pasurinë e tashmë dhe të ardhme.

Duke qenë se prokuroria nuk ka kërkuar pavlefshmërinë e veprimeve juridike konform nenit 22 pika 5 e ligjit të posaçëm, atëherë i padituri do të vihej në një situatë krejtësisht të padrejtë dhe të rëndë. Shuma që kreditorët kanë huadhënë të paditurin kap 85% të investimit, dhe se nuk gjendet në K.Civil, ndonjë dispozitë që meqënëse kreditori nuk provon që ka aftësi

paguese ose jo, të jetë i pavlefshëm veprimi juridik ndërkohë që debitori ka marrë paratë.

Po kështu duhet të merret në konsideratë fakti, se po nëse i padituri do të kishte marrë kredi në Banka, a do të duhej kjo e fundit të vërtetonte ligjshmërinë e pasjes së kësaj shume? Në një situatë analoge (sipas palës së paditur) janë edhe palët e treta.

Në këto kushte, pala e paditur kërkoi rrëzimin e kërkesës së prokurorisë dhe kthimin e sendit tek pronari, duke hequr edhe masën e sekuestros.

3.3. Pretendimet e përfaqësuesit të personave të tretë.

Përfaqësuesi i personi të tretë pretendoi se vërtetohet sipas deklaratës noteriale Nr.xxxx Rep. Nr.Kol.xxxx datë xxxx se shtetasi B. M. i ka dhënë hua të ndjerit I. B. shuma monetare në tre momente të ndryshme në vlera të përafërta, pëkatësisht në Mars 2011 shumën xxxx Euro, Qershor 2011 shumën xxxx Euro dhe Shkurt 2012 shumën xxxx Euro në total xxxx Euro. Shtetasi B. M. ka qënë fillimisht huadhënësi i parë që ka negociuar me të ndjerin për I. B. për ta ndihmuar në lidhje me hotelin në “xxxx”. Për këtë qëllim shtetasi B. M. ka marrë në datën xxxx fillimisht xxxx Euro hua nga z.Xh. M. dhe nëdatë xxxx shumën xxxx Euro hua nga H. M., fakte që vërtetohen nga nga kontrata e huasë Nr.xxx Kol datë xxxx dhe nga kontrata e huasë shkrese private e lidhur midis shtetasve H. M. dhe B. M..

Në vijim për të ndihmuar ndërtimin e hotelit duke qënë se shtetasi B. M. ka ushtruar aktivitet privat si person fizik në llogarinë e tij bankare në datë xxxx ka tërhequr shumën prej xxxx Lekë dhe në datë xxxx ka marrë hua nga shtetasi H. M. shumën prej xxxx (xxxx) Euro, fakte këto që vërtetohen nga dokumentat bankar vërtetim llogarie të shtetasit B. M. dhe kontratat e huasë shkrese private lidhur midis shtetasve H. M. dhe B. M.. Pas këtij momenti me të njëjtin qëllim ka tërhequr CASH nga llogaria e tij bankare si person fizik shumën xxxx Lekë si dhe ne shumen prej xxxx Euro nga xxxx Bank në datë xxxx.

Në datë xxxx shtetasi B. M. ka marrë hua nga shtetasi H. M. shumën xxxx Euro. Në datë xxxx tërheq nga llogaria e tij personale në xxxx Bank shumën prej xxxx Euro. Duke shtuar dhe xxxx Euro të cilat i kishte nga kursimet personale familjare, ka arritur te sigurojë shumën xxxx Euro për t’ia dhënë hua të ndjerit I. B. në fund të muajit Shkurt 2012. Këto fakte vërtetohen nga dokumenti bankar vërtetim llogarie B. M., kontrata e huasë shkrese private e lidhur midis shtetasave H. M. dhe B. M. dhe nga dokumenti bankar nxjerrje llogarie lëshuar nga xxxx Bank, dokumenti bankar nxjerrje llogarie lëshuar nga Banka xxxx.

Nga deklarata noteriale Nr. xxx Kol. datë xxxx vërtetohet se shtetasi A. M. i ka dhënë hua për nevoja të ndërtimit të hotelit të ndjerit I. B. shumën prej xxxx (xxxx) euro, në datë xxxx. Si pasojë e zotërimit të një firme ndërtimi në

xxxx, shoqëria "xxxx" sh.p. k ka kryer në disa momente tërheqje CASH nga llogaria bankare. Sipas dokumentave bankare të lëshuar nga Banka xxxx për llogaritë bankare të shoqërisë "xxxx" sh.p.k, në total shtetasi A. M. vetëm në llogarinë e shoqërisë në Euro në Bankën xxxx ka tërhequr CASH nga viti 2009 deri në fund në vitin 2012 shumën xxxx (xxxx) Euro si dhe shumën xxxx (xxxx) Lekë, pra provohet se shtetasi A. M. ka patur mundësi finaciare për të ndihmuar të nderin I. B..

Shtetasi H. M. rezultoi se në muajin Tetor të vitit 2012 i ka dhënë hua të ndjerit I. B. shumën prej xxxx Euro. Vërtetohet se në datë xxxx shtetasi H. M. ka lidhur kontratë me shoqërinë "xxxx sh.p.k për shitjen e disa makinerive që i zotëronte shoqëria e zotëruar nga ortaku i vetëm M. sh.p.k. Vlera e kësaj shitje është në vlerën xxxx Euro, vlerë të cilën shtetasi H. M. e ka poseduar pas datës xxxx sipas kontratës së shitjes me kusht. Përveç sa më sipër, shtetasi H. M. ka administruar dhe është sjellë si pronar i pasurive të nënës së tij, gjithmonë me marrëveshje me të. Konkretisht si pronare trualli nëna e tij znj.D. M. ka lidhur kontratë me shoqërinë ndërtuese "xxxx" shpk në datë xxxx. Te gjitha përfitimet e shtetasës D. M. i janë dorëzuar djalit të saj shterasit H..

Në datë xxxx nëpërmjet Kontratës së Prenotimit Nr. xxxx Rep rezulton se shtetasja D. ka marrë totalisht në CASH çmimin e shitjes prej xxxx Euro nga bleresi A. M. dhe në datë xxxx ka shitur një apartament tjetër tek blerësi A. K. duke përfituar shumën prej xxxx Euro. Pra vërtetohet nga sa më sipër se në muajin Gusht të vitit 2012, shtetasi H. M. ka patur CASH në posedim të tij vlerat monetare prej xxxx Euro.

Gjithashtu edhe shtetasi A. G. i ka dhënë hua nga paratë e kursyera prej tij nga aktiviteti i kambizmit prej vitit 1993 deri në vitin 2007 të ndjerit I. B..

Sipas përfaqësuesit të personit të tretë të gjitha dokumentat e paraqitura janë tërësisht të rregullta nga pikpamja formale dhe gjithashtu materialisht vërtetojnë burimet e ligjshme të qarkullimeve monetare mes personave që kane patur prej vitesh lidhje pune dhe shoqërore.

Për të mbështetur pretendimet e tyre në gjykim, në funksion të provueshmërisë së saj edhe përfaqësuesi i personave të tretë kërkoi marrjen në cilësinë e provës të deklaratave të parashtruara nga përfaqësuesi i palës së paditur, për të provuar mundësinë ekonomike të personave të tretë për dhënien e shumave të përcaktuara në deklaratat noteriale, përfaqësuesi i personave të tretë paraqiti në cilësinë e provës këto akte procedurale:

i "Kontratë Paraprake Shitblerje e sendit të ardhshëm", Nr.xxxx Rep. Nr.xxxx Kol, datë xxxx, (bashkangjitur Planimetria dhe leja e ndërtimit), e lidhur ndërmjet Shoqëria xxxx sh.p.k, D. M., dhe A. K., nga e cila përftohet e

dhëna se shtetasja D. M. pronare trualli do të shiste një apartament xx m2, palës blerëse, pasi ta ndërtonte sipërmarrësi kundrejt një shume prej xxx (xxxx) Euro, xxxx (xxxx) euro të likujduara në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe xxxx euro më datë xxxx.

ii. Kontratë Prenotimi, Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, lidhur ndërmjet shtetasës D. M., Shoqërisë xxxx sh.p.k dhe A. M. (blerësi), nga e cila përftohet e dhëna se shtetasja D. M. i shet një apartament prej xx m2 (pasi të ndërtohet), blerësit A. M. në shumën prej xxxx (xxxx) Euro, e cila sipas kontratës është e likujduar plotësisht.

iii. Deklarat Noterjale Nr.xxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx, nga e cila përftohet e dhëna se shtetasja D. M., deklaron: “...D. M. deklaroj me përgjegjësinë time të plotë ligjore se ...jam pronare në pasurinë Nr.xxxx me sipërfaqe prej xxx m2, të cilën e kam dhënë për ndërtim...në datë xxxx, kam shitur në favor të R. S. apartament me vlerë xxx euro, në datën xxxx, kam shitur në favor të A. K., apartament me vlerë xxxx euro, në datën xxxx, kam shitur në favor të L. J. apartament me vlerën prej xxxx euro,. Në datën xxxx, kam shitur në favor të Z.A.d M. apartament me vlerën xxxx (xxxx) euro, në total xxxx (xxxx) euro. ...deklaroj se këto vlera në momentin që i kam marrë ja kam dorëzuar djalit tim H. M., vlera të cilat i ka administruar dhe investuar në iteres të familjes tonë...”.

iv. Marrëveshje Huaje (nënshkruar nga dy palët jo e përpiluar me akt noterial) e datës xxxx, në të cilën ndër të tjera pasqyrohet: “H. M. ...huadhënësi, dhe B. M. ...Huamarrësi. Palët deklarojnë se huamarrësi ka marrë nga huadhënësi në datën xxxx, shumën orej xxxx Euro (xxxx) në para Cash. Huamarrësi ka marrë nga huadhënësi në datë xxxx, shumën prej xxxx (xxxx) Euro. Huamarrësi ka marrë nga huadhënësi në datën xxxx, shumën prej xxxx (xxxx) Euro cash. Në total huadhënësi i ka dhënë huamarrësit shumën totale prej xxxx euro, të cilën huamarrësi detyrohet ta kthejë brenda datës xxxx pa interes...Nëse huaja nuk kthehet brenda kësaj date atëherë huadhënësi do të zërë vendin e huamarrësit B. M. në të gjitha kreditë e tij që B. M. ka ndaj të ndjerit I. B. pa përjashtim...”

v. Kontratë Huaje vlerash valutore datë xxxx, lidhur ndërmjet huadhënësit Xh. M. dhe huamarrësit B. M. në të cilën ndër të tjera pasqyrohet se: “...Pala huadhënëse Xh. M., nisur nga morali i besimit reciprok dhe për nevoja financiare i kam dhënë hua jashtë kësaj zyre me datë xxxx Z.B. M. një sasi vlerash valutore në shumën prej xxxx (xxxx) euro, duke ja dhënë pa interes për një periudhë kohe kthimi të kësaj shume brenda datës xxxx..unë pala huamarrëse B. M. (është shënuar M. por që nga përmbajtja e kontratës bëhet fjalë për B. M.), pranoj lidhjen e kësaj konterate pasi jashtë kësaj zyre nga pala huadhënëse me datë xxxx, kam marrë shumën prej xxxx (xxxx) euro...e pranoj si

detyrim borxhi duke pranuar që t'ja kthej brenda datës xxxx....pranoj dhe autorizoj që shlyrja e këtij detyrimi kontraktor të bëhet drejtpërsëdrejti nga depozitat bankare, dhe nga kreditë e mija tek të tretët duke pranuar edhe vënien e barrës hipotekore mbi çdo pasuri...".

vi. "Statement Account", nga e cila përftohen të dhënat në lidhje me veprimet bankare të bëra nga klienti B. M. në Bankën xxxx, për periudhën xxx, si dhe të dhëna të marra nga Banka xxxx, ku përfshihen të dhënat në lidhje me veprimet bankare të bëra në këtë bankë nga klienti "xxxx", Sh.p.k.

vii. Ekstrakt date xxxx, nga e cila përftohet e dhëna në lidhje me të dhënat e marra nga Qkr në lidhje me subjektin "xxxx" Sh.p.k.

viii. Kontratë Shitblerje me kusht, Nr.xxx Rep. Nr.xxx Kol, datë xxxx, lidhur ndërmjet shitësit Shoqëria "xxxx" sh.p.k, përfaqësues ligjor dhe ortak i vetëm H. M. dhe Shoqërisë "xxxx" sh.p.k, nga e cila përftohet e dhëna se shoqëriaku objekt i kësaj kontrate është Makineri për përpunim letre, me një vlerë gjithësej prej xxxx (xxxx) euro, ku xxxx (xxxx) euro janë shlyer ditën e nënshkrimit të kontratës, shuma prej xxxx euro me datë xxxx, dhe shuma prej xxxx euro me datë xxxx.

ix. Kontratë Bashkëveprimi Nr. xxx Rep Nr. xxx Kol, datë xxxx, lidhur midis palës sipërmarrëse dhe investitore shoqëria "xxxx" Sh.p.k dhe palës pronare të truallit D. M. nga e cila u përftua e dhëna se pala pronare e truallit i jep të drejtë pale sipërmarrëse të drejtën për të ndërtuar një objekt shumëkatësh në një sipërfaqe tokë truall prej xxx m² e regjistruar në ZRPP- xxxx.

x. Pasqyrat Financiare 2011-2012, nga e cila u përftua e dhëna në lidhje me pasqyrat financiare të subjektit tregtar "xxxx", me administrator dhe ortak A. M..

Personat e tretë H. M., B. M. dhe A. M. nëpërmjet avokatit I. D., mbajtën qëndrimin se personi i tretë B. M. nga Mars 2011 deri në Shkurt 2012, ka dhënë hua të ndjerit I. B. shumat prej (në total) xxxx (xxxx) euro. Këto shuma personi i tretë i ka patur në disponim madje ka marrë hua tek të tretët për këtë qëllim. Kështu sipas kontratës përkatës B. M. ka marrë me datë xxxx fillimisht xxxx euro nga Z.Xh. M., dhe me datë xxxx shumën xxxx euro tek H. M..

Gjithashu sipas pretendimeve të kësaj pale, B. M. ka terhequr nga llogarie e tij personale (ku ka ushtruar aktivitet tregtar si person fizik) me datë xxxx, shumën prej xxxx (më shumë së xxxx euro), dhe me datë xxxx, ka marrë hua nga H. M. shumën prej xxxx euro, (ku me këtë të fundit ka kontratë huaje shkresë private), shuma të cilat ai ja ka dhënë hua të ndjerit I. K.. Po kështu sipas kësaj pale, B.

M. ka patur disa llogari në banka të ndryshme dhe nga terheqjen në llogaritë personale, ka patur në dispozicion në datat të ndryshme në vitin 2011 rreth xxxx euro. Me datë xxxx, ka marrë hua nga H. M. shumën prej xxxx euro, si dhe ka tërhequr nga llogaria personale në xxxx Bank xxxx euro, dhe nga llogaria e familjarëve xxx euro (në vitin 2012). Në mbështetje të këtyre pretendimeve kjo palë ka paraqitur disa akte dhe prova të cilat janë cituar tek provat shkresore.

Personi i tretë A. M. nëpërmjet mbrojtësit, mbajti qëndrimin se ai i kishte dhënë hua të ndjerit I. B. shumën prej xxxx (xxxx) euro në datë xxxx (kjo sipas deklaratës noterjale nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx). Sipas kësaj pale, A. M. është ortak i vetëm dhe administrator i subjektit tregtar “xxxx” shpk, dhe duke u nisur nga dokumentacioni bankar për periudhën nga 2009-2012, A. M. ka tërhequr në CASH nga llogaria e kompanisë së tij shumën prej xxxx euro. Ndërsa për të njëjtën periudhë A. M. ka tërhequr në llogari të shoqërisë shumën prej xxxx lekë. Pra ai ka patur mundësi dhe para që të jepte shumën në fjalë hua të ndjerit sa më lart.

Personi i tretë H. M., i ka dhënë hua në muajin Tetor 2012 shumën prej xxxx euro, të ndjerit I. B. dhe se këto shuma i ka patur të ligjshme dhe në dispozicion.

Sipas kësaj pale, ai i ka dhënë në tre momente të ndryshme hua B. M. në shumën prej xxxx euro, të cilat ky i fundit i ka përdorur për t’i dhënë hua tek i ndjeri I. B.. H.M., me datë xxxx, ka lidhur kontratë me shoqërinë xxxx shpk, për shitjen e disa makinerive ku vlera e kësaj shitje ishte xxxx euro, vlerë të cilën ai e ka poseduar që me datë xxxx.

Përveç sa më sipër, sipas pretendimeve të tij, H. M. ka administruar shitjet dhe është sjellur si të ishte pronar për pasuritë e nënës së tij D. M., ku kjo e fundit ka shitur disa apartamente me vlera përkaytësisht xxxx dhe xxxx euro, dhe nga sa më sipër vërtetohet (sipas tij), se në muajin Gush 2012 ai ka patur CASH shumën prej xxxx euro.

Ndërsa Gjatë gjykimit (dhe pas paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare nga organi i akuzës, kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor) përfaqësuesi i personit të tretë B. M., kërkoi që të bëhej shtesë e aktit të ekspertimit Kontabël (pas paraqitjes së aktit shtesë të bërë nga ekspertja kontabël), që të verifikohet situata financiare e B. M.a jo vetëm në Mars 2011, por edhe në Qershor 2011 dhe Shkurt 2012, kur ai kishte kryer veprime kontraktore.

Gjykata me vendim të ndërmjetëm, rrëzoi kërkesën e paraqitur nga pala e tretë pasi ata i kanë patur të gjitha mundësitë për të shtruar pyetje që në kryerjen e aktit të ekspertimit ashtu edhe kur ekspertet ju lanë detyra shtesë, si dhe nisur nga përgjigjet e ekspertet sipas pyetjes së lënë nga gjykata, nuk u çmua e nevojshme dhënie e detyrave të tjera shtesë ekspertet (një pretendim i tillë është paraqitur edhe në konkluzionet e depozituara në kryesekretari).

Personi i tretë A. G., nëpërmjet mbrojtësit të tij mbajti qëndrimin se ai i kishte dhënë hua të ndjerit I. B. në shumën prej xxxx euro, sipas deklaratës noteriale të hartuar tek noteri, shumë e cila i ishte dhënë CASH, dhe se këtë shumë ai në atë kohë e kishte disponuar dhe e kishte si rezultat i punës së ligjshme, ku ndër të tjera për shumë kohë kishte ushtruar aktivitet si kambist (këmbim valutor). Gjithashtu, kjo palë mbajti qëndrimin se akti i ekspertimi (kontabël) është i metë, pasi ekspertja nuk ka përlogaritur si të ardhura përfitimet e shtetasit A. G., që i ka realizuar nga këmbimi valutor, duke mos marrë për bazë aktet e dosjes së Prokurorisë xxxx, dhe as dëshminë e dëshmitarëve.

3.4. Aktet e ekspertimit.

Nga akti i ekspertimit të kryer nga eksperte vlerësuese L. B. i datës xxxx, është bërë vlerësimi mbi pronat truall me sipërfaqe xxxx m katror, xxxx dhe i një godine shërbimi x-x katë me restorant x kat e një ambienti ndihmës në katin x me sipërfaqe totale xxxx m katror. Sipas aktit të ekspertimit vlera e shitblerjes së trualit është xxxx lekë. Sipas kontratës së kaparit vlera është xxxx Euro.

Ndërsa godina x-x katë me restorant x kat e një ambienti ndihmës në katin x me sipërfaqe totale xxxx m katror ka si vlerë në momentin e kryerjes së aktit, atë prej xxxx lekë.

Bashkëngjitur aktit është dhënë një raport vlerësimi i gjerë mbi dy pronat ku përshkruhen imtësisht treguesit e vlerësimit të pronës. Në shpjegimet e dhëna nga ekspertia I. B. e pyetur nga palët dhe gjykata, ekspertja sqaron se *“Vlera që kam llogaritur une është xxxx afërsisht, është vetëm për godinën, ndërsa në raportin e vlerësimit është xxxx, do të thote që vlera e llogaritur nga une është me e lartë nga ajo e llogaritur në momentin e bërë nga Prokuroria. Une jam referuar vetëm dispozitave ligjore. Në kushtet kur ky është një objekt i pa mbaruar, që nuk është venë në punë, menyra e përfitimit ligjor është me anë të Aluiznit, në të gjitha referencat i jam referuar vetëm çmimeve manuale të miratuara me VKM, këtu bëhet fjale me godinën. Nëse do flas për truallin ai është xxxx metra dhe vlera e investimit të tij neqoftese do ta quajme vlerë investimit, në bazë të kontratës së kaparit, çmimi i tij xxxx euro. Ndërsa sipas VKM-se vlera është xxxx leke. Une i kam venë të dyja rastet sa është në VKM. Në këtë rast vlera e investimit është ajo që është derdhur, pra që është paguar dhe është xxxx euro. Nëse është paguar apo jo në total në kontratën e kaparit nuk del e qarte sesa është paguar me vone. Por fakti që në procesin e legalizimit të objektit, është kaluar objekti në legalizim duke e quajtur Sh. B. pronar trualli, do të thote që kjo pagesë është kryer besoj në masën 100%. I jam referuar çmimeve referuese të ndertesës, tek çmimet referuese të vitit 2014. Pergatitja e dokumentacionit për nxjerrjen e çmimeve hartohet nga një vit në tjetrin, domethënë nga viti 2013 në vitin 2014. Nuk kishte çmime referuese për vitin 2013. Çmimet janë miratuar me një udhëzim në muajin Gusht 2014. Në përlogaritjen e çmimeve kam bërë një analizë të gjendjes së ndertimit, faktikisht në atë ndertim nuk punohej, ishte i braktisur. Dukej që kishte shumë kohe që nuk punohej dhe ato punime që ishin bërë kishin filluar të merrnin ngjyre balte të kuqe. Do të thote që nuk është bërë me asnjë lloj investimi nga momenti që është sekuestruar. Une kam bërë një analizë të fotografimit ajror të atyre viteve dhe në fotografimin*

ajror te vitit 2014 me rezulton qe gjendja objektit duket e mbuluar me solete ne kete gjendje aktuale siç duket edhe sot. Siç dukej ne vitin 2014 duket edhe sot po ta shikojme fotografimin ajror. Une i jam referuar faktit qe deri ne vitin 2014 keto punime jane ruajtur, dhe kam ruajtur çmimin mesatar qe edhe neqoftese eshte bere ndonje punim nga 2014-ta deri ne 2015-ten, fakti qe une kam qendruar tek çmimet e 2014-tes kur punimet jane bere nga viti 2012, 2013, 2014 eshte nje mesatare kjo e vitit 2014.

Nese dihet qe kjo ndertese ka qene e konfiskuar dhe nuk ka levizje, dihet qe kjo shtate eshte e njejte me momentin e konfiskimit, perderisa une sot e konstatoj te tille. Nuk mund te them si ka qene ne momentin e konfiskimit sepse nuk kam asnje dokument qe te vertetoje kete. Ka degradime dhe amortizime te cilat i kam pershkruar ne akt. Une i jam referuar fotografive dixhitale duke qene se konstrukti i godines nuk ka pesuar ndryshime. Edhe persa i perket shtrirjes horizontale dhe vertikale duket qe eshte e njejta shtate si sot ashtu dhe ne vitin 2014, punimet e tjera mund te jene te brendshme. Legalizmi i objektit eshte bere ne date 17.09.2013. Çmimi referues i imi mendoj se duhet te jete 2013-2014 per nje arsye: Ne fotografimin ajror deri ne muajin Shtator 2012 ky objekt nuk ka ekzistuar, kjo do te thote qe punimet kane filluar pas shtatorit te 2012. Atehere jemi ne vitet 2012, 2013, 2014, kemi edhe 2015 deri ne sekuestrim. Une kam marre nje mesatare vitin 2014 sepse çmimet e vitit 2014 jane analize e nje viti me perpara, domethene nga gushti i vitit 2013 deri ne gusht 2014. Por konstatojme qe, ne te njejten kohe kemi nje dokument te blerjes se tokes, truallit, i cili eshte ne vitin 2013, qe do te thote se investimi ka filluar pak me perpara por jo pa zgjidhur konfliktin me token. Une flas me keto prova qe kam ketu, me keto qe kam ketu mua me rezulton pas shtatorit te 2012. A eshte ligjore marrja ne google, une di te them qe "Google Earth" eshte nje program profesional, çdo qytetar mund ta shikoj qe ekziston nje ndertese apo jo por nuk mund te marre kushdo informacion qe merr nje specialist. Duhet te sqaroj se sot nga programet e internetit po behen legalizimet e banesave. Une disponoj vete nje fotografim ajror te vitit 2007 sepse kam bere nje akt dhe objekti ne kete vit nuk eshte. Kjo do te thote qe eshte ndertuar pas 2007. Deri ne momentin e konfiskimit ne vitin 2015 ka qene duke u punuar atje, jane vendosur dritaret. Nga 2012-ta qe e konstatoj une, deri ne vitin 2015 eshte marre mesatarja viti 2014. E shpjegova pak me pare qe çmimet referuese te vitit 2014 jane analize e nje viti te meparshem, domethene jane çmime nga muaji Gusht i vitit 2013 deri ne Gusht 2014 kur jane shpallur keto çmime, sepse analizohet tregu. Keto çmime jane si mesatare e nje viti me perpara. Eshte marre si mesatare prandaj eshte ruajtur çmimi i vitit 2014 per te eliminuar te gjithë keto faktore te panjohur nga ana ime dhe te pa dokumentuar ne dokumentacionin qe ndodhet aty. Perderisa nje objekt i tille nuk mund te ndertohet ne nje dite, do te thote qe shtihet ne nje kohe te caktuar. Une mund te llogaris punimet e dokumentuara deri ne 2013-ten, ato qe duken nga jashte. Nga viti 2013 deri ne vitin 2015 do t'i ndaj me vete. Legalizimi i objektit behet kur ka perfunduar si karabina dhe nga ana e jashtme duket i perfunduar. Mund te kete punime nga brenda pa ndarje dhe legalizimin e objektit e ben. Ne ate viti kur eshte bere legalizimi ka qene me e ulet vlere. Diferencat jane te vogla por ka diferenca. Duhet te bej nje analize persa i perket diferencat se çmimit nga njeri vit ne tjetrin. Me duhen disa dokumenta qe tregojne gjendjen ne momentin e legalizimit. Nje dokument i tille paraqitet ne zyren e Aluiznit por kjo perjashton qe te shikoj gjendjen e objektit brenda, nga jashte mund ta shikoj por nga brenda jo. Me keto

dokumentacione e kam dhene pergjigjen, eshte kjo vlere. Per te dhene vlere tjeter kerkoj dokumentacion per ta ndare qe kjo eshte bere ne kete kohe. Me figuron qe ne Shtator 2012 ka filluar objekti. Ne dijenine time dhe te dokumentacionit qe eshte aty, objekti eshte sekuestruar ne Gusht 2015. Une nuk e ndaj dot se ke punim ka kryer ne fillim dhe ke punim ka kryer me vone. Ne vitin 2013 eshte bere legalizimi, ne vitin 2014 ai ka deklaruar qe nuk punon me, megjithate une i kam bere llogarite duke marre ne konsiderate deri ne vitin 2015 kur eshte mbajtur procesverbali i sekuestrimit. 50% shkon karabinaja dhe 50% shkojne punimet e tjera. Perserisa me figuron qe deri ne Shtator te vitit 2012 objekti nuk ekzistonte, do te thote qe pas kesaj periudhe kane filluar punimet dhe i bie qe jane tre muaj. Perderisa une nuk e kam te pasqyruar me faza sa eshte ndertuar nga njeri vit ne tjetrin jam e detyruar te ruaj kete mesatare.

Mbi pyetjen e gjykatës, se sa ishtë vlera e tregut dhe a kishte ndonje diferencë midis vlerës referuese të çmimeve sipas VKM-së dhe vleres që do të kishte kjo pasuri në momentin e blerjes, ekspertja p është përgjigjur:

“Duke qene se i kam analizuar me shume kujdes fotografimet ajrore terreni eshte shume i aksidentuar, do te thote qe vendi i sheshte ishte shume i vogel ne krahasim me siperfaqen e blere. Jane blere toka firo, shkembinj te rene qe nuk sherbejne per asgje. Ne ate gjendje qe ka qene ne momentin e pare trualli, ka qene ne nje suate jo te mire ndertimore, e shumta mund ta blinte dikush per te bere nje shtepi me siperfaqe te vogel, pjerresia e terrenit eshte shume e madhe mundesia qe te jepte per ta zhvilluar ishte shume e vogel. Them qe duke mos patur mundesi te bej nje verifikim, eshte shume e veshtire qe ta besh me vleren e tregut sepse duhet te kesh prova. Prandaj i jam referuar Udhezimit te Keshillit te Ministrave. Sot e ben per vleren e tregut qe ka sot por per vleren e tregut ne momentin e blerjes eshte pak e veshtire.”

Nga **akti i ekspertimit kontabel i datës xxxx** i hartuar nga eksperte kontabël e autorizuar F. S. del se nuk mund të kryhen llogaritje dhe të nxirren përfundime për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Sh. B. dhe familjarët e tij ashtu dhe për shpenzimet e këtij shtetasi e familjarëve të tij deri në datën 1 janar 1994. Ndërsa për sa i përket periudhës për perudhën nga Janar 1994 e deri në Mars 2014, vlera totale e depozitave të përbashkëta të paditësve Sh. B. e M. B., bashkë me vlerat e interesave dhe vlerën e deklaruar nga shitja e bagëtive në Nëntor 2006, shkon në shumën xxxx lekë. Për të ndjerin I. k. del se ka mjete monetare të raportuara si hyrje në euro për periudhën 2012 – 2014 në llogari bankare në vlerën xxxx euro ose xxxx lekë.

Totali i mjeteve financiare të përdoruara nga shtetasi Sh. B., i shprehur në lekë është xxxx lekë. Në lidhje me raportin në mes të të ardhurave dhe shpenzimeve të shtetasis Sh. B. për periudhën 1 janar 1994 – mars 2014 nga akti i ekspertimit del se shuma e mjeteve monetare për periudhën në fjalë është xxxx lekë dhe rezultom që të ket një mungesë likujditeti në shumën xxxx lekë.

Në lidhje me detyrat për përcaktimin e situatës finnciarë të personave të tretë Ekspertja ka hartuar një raport përmbledhës e sqarues me datën xxxx. ekspertia ka dhën sqarimet në

senacë gjyqsore i pyetur nga përfaqesuesi i palës së tretë duke sqaruar se “ Ne lidhje me personat e interesuar gjykata me ka percaktuar periudhen, muajin e nje viti te caktuar per te cilen une duhet te pergjigjem per situaten finaciare. Per B. M., ne muajin Mars 2011 dhe sipas dokumentave qe gjenden ne dosjen hetimore dhe gjyqsore jane vetem deklarata noteriale te cilat japin shkembimin e mjeteve monetare mbi bazen e pergjegjesive personale qe ka deklaruar gjithesecili. Hyrje dhe dalje te mjeteve monetare ne llogari bankare nuk ka, ka vetem shkembim te mjeteve monetare njashte ketyre kanaleve. Neqoftese do te thuhet per muajin Prill 2011, ne kete muaj nuk ka asnje veprim, ka thjesht deklarata per vitin 2010, ne muajin Mars nuk ka. Te gjitha dokumentat te cilet une i kam listuar ne gjashte faqet e para, qe i kam cituar, ju kam dhene pergjigje. Ato mjete monetare qe jane marre sot, neqoftese jane marre ne vitin 2010 se per çfare jane perdorur une nuk e di. Pra, une nuk mund te them qe ne muajin Mars-Prill 2011, per njerin person B. M., neqoftese per zoterine tjeter eshte kerkuar ne 2012, per zoterine e trete eshte kerkuar ne 2013-ten, ne momentin qe me eshte kerkuar mua, une nuk e di per çfare jane perdorur. Per secilin, per muajin qe me eshte kerkuar une kam dhene gjendjen nese kane patur apo jo veprime. Duke qene se jane edhe deklarata jo noteriale, neqoftese une duhet te pranoj dhe te shpreh siguri qe ne Mars te vitit 2014, mbi bazen e nje deklarate jo noteriale B. M. zoteron xxxx euro, nuk kam si ta jap sepse kjo eshte nje deklarate jo noteriale. Nese gjykata e quan te arsyeshme ta pranoje, keto xxxx euro. Me te njejten llogjike kam vepruar per te gjithë personat e tjere. Ndersa ne lidhje me personin e fundit A. M. per te cilin eshte pretenduar se ka mundesi finaciare, duke dorezuar pasqyrat apo bilancet finaciare te shoqerise qe zoteron, duhet te theksoj qe Shoqerite me Pergjegjesi te Kufizuar kane personalitet juridik, qe do te thote se jane ato zoteruesit e pasurive, per kete arsye te gjitha raportimet qofte te llogarive bankare qofte te pasqyrave finaciare jepen me emrin e Shoqerise. Ne kete moment ata jane te detyruar te reskpektojne ligjin per shoqerite tregtare dhe ligjin per kontabilitetin, ku regjistrimet kryhen te gjitha ne emer te Shoqerise dhe ne nje moment te caktuar te gjitha terheqjet qe mund te jene bere nga banka, nga llogatite bankare te Shoqerise, jane ne dispozicion te Shoqerise. Aty ka vetem nje terheqje dividenti e raportuar ne pasqyrat finaciare per llogari te vitit 2012, te bere ne vitin 2013. Por nuk jepet muaji, data nese eshte terhequr apo jo. Dividenti merret ne raport me fitimet e shoqerise. Fitimet e shoqerise, leket jane lene ne Shoqeri dhe nga Shoqeria eshte terhequr nje dividend. Nga ky xxxx lekesh dividend paguhet 10% per shtetin tatim mbi dividendin dhe mbetet qe, neqoftese ai i ka terhequr sepse une nuk e kam te dokumentuar, ka patur nga aktiviteti i shoqerise i kane takuar atij si ortak xxxx leke. Jane bere ne emer te Shoqerise, per shitjeblerje, per aktivitetin opertativ te Shoqerise. Ne zbatim te kerkesave ligjore asnje ortak, as aksioner nuk ka te drejte te terheqe mjete monentare nga llogaria per perdorim personal. Neqoftese do t'i kishte terhequr per perdorim personal, atehere paraqitet ne pozicionin perkates ne debit e shoqerise. Edhe dividendet qe kane te drejte ti terheqin nese nuk ka aftesi paguese shoqeria nuk lejohet te terhiqet. Paraqitet si detyrim qe shoqeria ka ndaj ortakut apo ndaj aksionerit, por nuk terhiqen neqoftese nuk leshohet çertifikata e aftesise paguese dhe depozitohet kudo sepse nuk mund te prishet vazhdimesia e aktivitetit te Shoqerise.

Neqoftese une kryej supozojme auditim te pasqyrave finaciare te A. M. dhe aty shikoj qe ka terheqje te mjeteve monetare me qellim perdorimin personal, qe aktiviteti nuk

eshte raportuar drejte, qe ka fshehje te te ardhurave, qe ka fshehje te perdorimit te mjeteve monetare, qe ka raportime jo te drejta ne saje te gabimeve apo te mashtrimeve, ne kete moment jap nje opinion dhe ky quhet raport i auditimit me opinion dhe me siguri. Me siguri neqoftese jane te drejta, me rezerve kur nuk hedh poshte te gjitha pasqyrat e auditimit por vetem nje pozicion te caktuar, dhe kunder kur jo vetem qe refuzohen por jane ne ate gjendje qe pasqyrat financiare paraqesim rrezikshmeri.

Ne lidhje me B. M. (ekspertja citon aktin e ekspertimit, detyren Nr.x). Neqoftese eshte “e ardhur”, e ardhura ka burime te ndryshme te cilat nuk kane kthim, e ardhur nga paga, e ardhur nga sigurimet shoqerore, e ardhur nga pronesia, e ardhur nga nje dividend, te ardhura me burime te ligjshme. Nese une ne kete moment them qe kam xxxx euro dhe them qe i kam borxh, kjo nuk eshte e ardhur por eshte borxh. Per kete arsye referuar pyetjes, duhet te ndahen konceptet drejte, te ardhurat e tij dhe te familjareve te tij. Te percaktohet raporti i te ardhurave me shpenzimet ne kete periudhe, referuar certifikates se gjendjes familjare. Ne faqen 27, paragrafi i fundit jam pergjigjur (ekspertja citon pjese te aktit te ekspertimit). Shumen qe e ka gjendje, nuk e di si ka hyre kjo shume ne banke sepse burimin nuk e kam.

Sipas marreveshjes se huase jo noteriale, date xxxx midis H. M. dhe B. M., per vleren totale te borxhit prej xxxx euro ne vitet 2011-2012, dhene nga H. M., B. M. me afat shlyerjeje deri ne date xxxx pa interesa, eshte e perfshire brenda shumes xxxx euro edhe vlera e huase prej xxxx euro marre prej tij ne date xxxx, sepse i pergjigjem pyetjes se gjykates se cila ka qene gjendja ne date 03 Mars. Ai ne date 03 Mars ka marre xxxx euro nga H. M.. A eshte e ardhur apo nuk eshte, nuk e them sepse eshte kontrate huamarrje. Ne deklaraten noteriale me Nr. xxx Rep. dhe Nr.xxxx Kol, date xxxx “Per marrje persiper nga Sh. B. te borxhit te te birit te ndjere I. K.”, ndaj B. M. ne vleren xxxx euro, me interes vjetor 2% sipas datave te borxhit deri ne daten e shlyerjes se tyre, eshte e perfshire njohja e borxhit prej xxxx euro. ,,

Mbi pyetjen e gjykatës se a ekzistonte mundësia ekonomike e mbulimit të shpenzimeve përsa i përket blerjes së pronave përkatese, ekspertja F. S. është përgjigjur: “ Referohet qe Sh. B. dhe familjaret e tij, te ardhurat e krijuara nga puna apo nga burime te tjera nuk ka. Ka hyrje te mjeteve monetare ne llogari bankare qe nga viti 2002 ne fillim ne dollare, pastaj ne euro dhe me vone ne leke, me burim te papercaktuar. Si rezultat i hyrjes se ketyre mjeteve monetare ne llogari bankare ne formen e depozitave bankare jane krijuar te ardhurat nga interesat si rezultat i depozitimeve. Totali i hyrjeve te mjeteve monetare me totalin e te ardhurave perfaqesojne vleren qe une kam dhene rreth xxxx. Nese gjykata do ta çmoje te arsyeshme qe ta çmoje si te ardhur edhe vleren e shitjeve te raportuar te bagetive, dhenve dhe dhive, atehere do ti shtohet edhe kjo e ardhur dhe shuma shkon ne vleren xxxx. Keto jane mjetet monetare qe paraqiten ne perdorim te te paditurit Sh. B.. Keto te ardhura fillojne nga viti 2002 deri ne vitin 2014, e theksoj sepse jemi duke presupozuar qe keto te ardhura jane krijuar dhe do te perdoren me nje qellim te caktuar. Pra ato te ardhura te hyra ne vitin 2002, 2003, 2003, dhjete vjet perpara se te fillonte ndertimi do ta çmoni ju te arsyeshme nese duhet te futen apo jo ne perdorim si burim mjetesh monetare. Ne lidhje me familjaret e tij nuk kane, por I. K. ka krijuar te nje depozite ne vitin 2012.

Nese do njihen edhe xxxx te ardhurat e deklaruar, nese do te perfshij edhe te gjitha hyrjet dhe ju do te njihni te gjitha borxhet e njohura nga Sh. B. mbi bazen e deklaratave noteriale, vlera totale e hyrjeve nga viti 2002 deri ne vitin 2014. Sekuestrimi eshte bere ne vitin 2015 por informacionin per llogarite bankare e kam deri ne Prill 2014, ku vlera totale shkon xxxx leke. Shuma prej xxxx leke eshte totali i mjeteve monetare te Sh. B., po i referohem tabelës Nr.xx, ndersa mjetet monetare te borxheve te kthyera ne leke mbi bazen e kursit mesatar te Bankes se xxxx jane xxxx leke. Siper tabelës eshte e shkruar pasqyrimi i gjendjes familjare pa ndikimin e pamundesise se perdorimit te mjeteve monetare si depozita bankare, pra sikur te gjitha keto mjete monetare i ka patur ne xhep dhe ka patur mundesi qe ti perdore. Pra qe nga viti 2002, ai i ka lene me qellim per investimin, ne supozim e mendojme te tille, atehere do te thote qe totali i ketyre mjeteve monetare jane xxxx leke, por nga kjo shume, xxxx leke, jane te perdorura. Tek te perdorurat futet llogaritja e shpenzimeve per jetese, e kostove te jeteses te llogaritura sipas shkreses se Instat-it. Eshte nje tabelë tjeter qe ka nje vlere xxxx , qe do te thote qe une i kam marre te mireqena qe sikur te gjitha keto mjete monetare qe kane qene ne xhepat e tyre, kane qene te mundshme te perdoren por duke bere bashkimin, shume algjebrike, plus-minus del perseri nje pamundesi e financimit per xxxx leke.

Sipas ekspertës referuar mundësisë ekonomike të të paditurit Sh. B., dhe përsa i përket hyrjeve dhe elementit të borxhit nga personat e tretë, mundësia e tij ekonomike deri në vitin 2014, shkonte xxxx lekë të vjetra, bashkë me borxhet. Deri në vitin 2014 mundësitë e tij ekonomike, duke marrë të mirëqena dhe të gjitha detyrimet që ai ka marrë nga të tretët, të pranuar prej tij, shkon në vlerën xxxx lekë të vjetra.

IV. Analiza ligjore dhe arsyetimi Givkatës mbi kërkesën, provat dhe pretendimet e palëve.

Ligji 10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar me ligjin nr. 70 /2017 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ka për qëllim parandalimin dhe goditjen ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, ndër të tjera për, pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/a, të Kodit Penal, dhe për kryerje të krimeve prej tyre apo kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet283, 283/a dhe 284/a, të Kodit Penal apo kryerjen e krimeve për qëllime të fitimit të pasurive të paligjshme, të parashikuara në nenet 114/a dhe 287, të Kodit Penal.

Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale,

sipas këtij ligji. Në interpretim të dispozitave sa më sipër (por jo vetëm), Gjykata çmon se kërkesë-padia e paraqitur nga organi i akuzës për konfiskimin e pasurive sipas objektit të kërkesës (cituar sa më lart) përfshihet në fushëzbatimin e këtij ligji. Pra sipas ligjit, bien në fushëzbatimin e tij pasuritë e personave për të cilët ka një dyshim të arsyeshëm bazuar në indicje për pjesëmarrje në një nga veprat e listuara në këtë dispozitë (neni 3/1 të ligjit).

Sipas ligjit, zbatohen dispozitat e ligjeve të tjera për aq sa është e mundur. Por vetë ligjvënësi sipas këtij ligji, ka ceduar në disa parime juridike civile dhe penale duke u nisur nga interesi publik, ku i ka kaluar barrën e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, dhe që i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi (neni 21/3 i ligjit 10192/2009). Kjo duke u bazuar edhe në aktet Ndërkombëtare siç është “Konventa mbi pastrimin, depiskimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”, Strasburg, 8.XI.1990, ratifikuar me Ligj nr.8646, datë 20.7.2000”, apo akte të tjera ndërkombëtare në fushën e Krimin të Organizuar.

Tek rrethanat e fakti, u pasqyrua se shtetasit E. B. alias E. B. alias E. M., është dënuar për disa vepra penale ndër to për blerje dhe dhënie e paligjshme lëndësh narkotike në vazhdimësi dhe në bashkëpunim sikurse parashikohet nga nenet 81, 110, të Kodit Penal....të kryer në datën xxxx, në Arezzo, sipas vendimit të datës xxxx, vendimi i Gjykatës së Apelit Firenze-s ka marrë formë të prerë në datën xxxx, (që duke patur parasysh dispozitën e Kodit Penal të R.Sh, e përfshin neni 283 i këtij Kodi); Për veprën penale: Pjesëmarrje në organizatë me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike sikurse parashikohet nga neni 74 paragrafi 2 i dekretit të Presidentit të Republikës...kryer në vitin 2008, për veprën penale; Importim dhe mbajtje e lëndëve narkotike në bashkëpunim ...të kryer nga datat xxxx dhe deri më datë xxxx në Romë dhe Belgjikë, që referuar dispozitave përkatëse të Kodit Penal të R.Sh, këto vepra penale parashikohen nga nenet 283/a, 333, 333/a. (si dhe në episode të tjera dhe i dënuar me vendim të formës së prerë që për të mos rënë në përsëritje referoju tek rrethana e faktit).

Po kështu, Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx ka rregjistruar procedimin penal për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 287 të K.Penal. Gjithashtu për të ndjerin I. K., alias K., B., B., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx alias S. S., ndër të tjera është i dënuar me vendim të formës së prerë të Autoriteteve Italiane për veprën penale; Nxitje e prostitucionit, sikurse e parashikhet nga neni 3, nr.50 i ligjit të datës 20.02.1958...kryer në vitin 1994, në datën 14/11.1997, vendimi i Gjykatës së Apelit të Milanos që ka marrë formë të prerë në datën xxxx, për veprën penale; Mbajtje dhe transport i lëndëve narkotike në bashkëpunim....të kryer me datë xxxx, në Otranto, në datë xxxx, vendimi i Gjykatës së Apelit të Lece-s ka marrë formë të prerë në datën xxxx, parashikuar nga dispozitat përkatëse të K.Penal të R.Sh nga nenet 283, 283/a të K.Penal.

Në fushëzbatimin e këtij ligji përfshihen edhe pasuritë e personave të afërm me personin mbi të cilin rëndon dyshimi i arsyeshëm për pjesëmarrje në një nga veprat e listuara sa më lart të

parashikuara në nenin 3 të këtij ligji: (bashkëshorti, fëmijët, **të paralindurit**, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehri, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka (paragrafi 2 pika a).

Në rastin konkret, gjatë gjykimit ndër të tjera rezultoi se pasuritë objekt konfiskimi janë të regjistruara në emër të shtetasit Sh. S. B., pra i afërt i subjekteve të përfshirë në veprimtarinë kriminale sipas nenit 3 paragrafi 1 i argumentuar sa më lart.

Gjithashtu sipas nenit 3 të ligjit në fjalë, në fushëzbatimin e ligjit (dhe për pasojë subjekte të tij) bien edhe: Pasuritë e personave fizike dhe juridik, kur ka të dhëna të mjaftueshme që zotërohen, qoftë dhe pjesërisht nga personat e dyshuar, në mënyrë të drejtëpërdrejtë a tërthortë dhe Pasuritë e personave fizike dhe juridikë për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se janë përdorur, apo kanë lehtësuar, kane ndikuar në kryerjen e veprimtarive të paligjshme nga personat e dyshuar si pjesëmarrës në listën e veprave penale që gjejne pasyrim në nenin 3.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj kërkesë, u provua plotësisht se ka dyshime të arsyeshme (*madje personat e përmendur sa më lart janë të dënuar me vendime të formës së prerë nga autoritetet e huaja, vendime të cilat në rastin konkret janë marrë në formë e kërkuar nga ligji të ardhura nëpërmjet Letërporosisë nga autoritetet Gjyqësore Italiane, dhe fuqia e tyre provuese nuk vihet në dyshim*), të bazuara jo vetëm në indicie por në prova, se ata janë përfshirë në veprimtari kriminale në disa nga veprat penale të listuara nga neni 3 paragrafi 1 i (pikat a,ç, d,) të ligjit 10192/2009, dhe se shtetasi Sh. B. është subjekt konform nenit 3/2 si i afër i këtyre personave (është babai i tyre).

Në interpretim të ligjit sa më sipër, nuk mjafton vetëm që pala e paditur të jetë subjekt i këtij ligji, dhe fushëzbatimi i ligjit, por kondicionohen edhe kushte të tjera që parashikohen shkrehimisht në nenin 24/1 i ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017.

Kështu në nenin 24 paragrafi 1 parashikohet shprehimisht:

“1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;

b) rezulton se pasuria është drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, në zotërim të plotë ose të pjesshëm të personave të përmendur në nenin 3, pika 1 e këtij ligji.

c) nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk arrin të përligjë zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, të cilat janë shpërpjestimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të ligjshme të deklaruara prej tyre.

Lidhur me kushtin e parë (pika (a) e paragrafit 1 e këtij neni) u arsyetua sa më lart se në rastin konkret dyshimet e bazuara janë jo vetëm në indicie por edhe në prova të pakundërshtueshme, siç janë vendimet e formës së prerë të autoriteteve Gjyqësore të shtetit Italian, për dënimin e subjekteve duke përcaktuar rrethanat e përfshirjes në këtë veprimtari, shkeljen e dispozitave përkatëse, kohën kur janë përfshirë (për të mos rënë në përsëritje referoju tek argumentimi i subjektit dhe rrethanat e faktit).

Përsa i përket pasurive objekt konfiskimi dhe prejardhjes së tyre sipas pikës b) paragrafi 1, neni 24 i ligjit, gjykata çmon se për t'u konsideruar se të ardhurat e një personi kanë qenë të ligjshme për tu marrë parasysh konform nenit **24/1/c të ligjit 10192/2009, i ndryshuar**, këto të ardhura duhet të pasqyroheshin nga të dhënat që nxirren nga organet e tatim/taksave, pasuri nga trashëgimia apo aktiviteti ekonomik i evidentuar nga organet kometente, dhe jo çdo "aktivitet i supozuar" pa qenë i formalizuar (në asnjë lloj mënyre), të pretenduar si kur janë nxjerrë të ardhura.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, nga palët në gjykim u paraqiten prova se pasuritë: Objekti truall me sipërfaqe parcele ndërtimore xxxx m², zona kadastrale xxxx, Lagj."xxxx" xxxx, dhe Objekti Ndërtesë me sipërfaqe totale xxxx m², me nr.pasurie xxxx, zona kadastrale xxxx Lagjia "xxxx" xxxx, janë të regjistruara në regjistrat publikë në emër të të paditurit Sh. B..

Ajo për të cilën gjykata do të argumentojë më poshtë është prejardhja e kësaj pasurie dhe zotërimi i pasurive që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave.

Mbrojtja e palës së paditur pretendoi se, objekti për të cilin pretendohet për t'u konfiskuar nga ana e Prokurorisë është një objekt i ndërtuar mbi bazën e të ardhurave të krijuara nga familjarët e familjes B. në Shqipëri dhe pjesëtarve të tjerë të familjes rezidente në shtetin italian prej shumë vitesh. Kjo pronë është e regjistruar në emër të Sh. B. thjesht si kryefamiljar dhe për të ruajtur unitetin dhe harmoninë familjare. Përsa i erket provave për të provuar këto pretendime, shtojmë se përveç këtij kontributi, një pjesë e mirë e këtij ndërtimi është realizuar nëpërmjet huamarrjeve tek subjekte të tjerë që janë thirrur si persona të tretë në këtë gjykim duke u bazuar tek deklarata noteriale Nr.xxxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx, midis shtetasve A. G. M. dhe Sh. B., deklarata noteriale Nr.xxxx Rep, Nr..xxx Kol, datë xxxx, midis shtetasve H. S. M. dhe Sh. B., deklarata noteriale Nr.xxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx, midis shtetasve A. D. G. dhe Sh. B., deklarata noteriale Nr.xxxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx, midis shtetasve B. Q. M.a dhe Sh. B..

Këto deklarata në totalin e tyre bëjnë fjalë për një shumë huamarrjeje në masën xxxx euro sipas mbrotjes. Njekohësisht, duke patur parasysh aktivitetin e familjarëve të familjes B. rezidente në shtetin italian me kod fiskal të verifikuar, kërkojmë të administrohen edhe aktet që ne kemi paraqitur përpara gjykatës në gjykimin e parë dhe që janë pjesë e fashikullit të prokurorisë. Aktet e nxjerra nga sistemi fiskal italian, përsa i përket aktivitetit

privat të realizuar nga subjektet B. B., G. B., A. B., L. B. me kodin fiskal të tyre, nuk mund të konsiderohen të paqena siç i ka konsideruar gjykata në gjykimin e mëparshëm të kësaj çështje. Ato ose do konsiderohen të fallsifikuara ose do shërbejnë si një indicie për marrjen e provave të plota dhe objektive duke garantuar një proces të rregullt ligjor.

Ndërsa sipas përfaqësuesit të personit të tretë qëllimi pse personat e tretë janë thirrur në këtë gjykim nuk është justifikimi i palës së paditur por mbrojtja e huave të dhena nga këta persona. Nisur nga debati në gjykimin e parë dhe nga vendimi i gjykatës, duhet të kemi parasysh dy parime tërëndësishme. Së pari, nuk është se ka ndonjë ligj që ndalon huadhënien tek personat me të shkuar kriminale, dhe fakti se një person është kriminel nuk e bën edhe huadhënësin kriminel, pra nuk tjetërsohet dënimi apo ekzistenca e aktivitetit kriminal tek personi që hyn në marrëdhënie juridike me këtë person. Personat e tretë bazohen tek provat e paraqitura prej tyre deklarata noteriale Nr.xxxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx, midis shtetasve A. G. M. dhe Sh. B., deklarata noteriale Nr.xxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx, midis shtetasve H. S. M. dhe Sh. B., deklarata noteriale Nr.xxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx, midis shtetasve A. D. G. dhe Sh. B., deklarata noteriale Nr.xxxx Rep, Nr.xxx Kol, datë xxxx, midis shtetasve B. Q. M. dhe Sh. B..

Gjykata çmon, se vlen të theksohet se e gjithë pasuria është vënë gjatë dhe pas përfshirjes në veprimtarinë kriminale argumentuar sa më lartë, dhe se nuk rezulton të kenë ushtruar aktivitet të ligjshëm apo të kenë përfituar të ardhura në ndonjë nga mënyrat e parashikuara me ligj.

Sipas provave shkresore ndër të tjera **“Kontartë Kapari” Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx**, lidhur ndërmjet F. I. M., trashëgimtarët e Sh. G. dhe Sh. S. B., objekt i kësaj kontarte është sipërfaqe totale prej xxxx m², regjistruar në ZVRPP xxxx, në zonën kadastrale xxxx, lagjia “xxxx“ xxxx, kundrejt një çmimi prej xxxx (xxxx) Euro.

Sipas përmbajtjes së kontratës sa më lart, rezulton se blerësi kishte paguar ditën e nënshkrimit të kontratës shumën prej xxxx (xxxx) euro, dhe se shuma prej xxxx (xxxx) euro, do të shlyhej deri me datë xxxx, sipas kondicioneve të kësaj kontrate, dhe rezulton se kjo pasuri është vënë pas përfshirjes në veprimtarinë kriminale të cituar sa më lart, ose të paktën është formalizuar në këtë kohë (kjo pasi vlerat monetare janë përfituar gjatë përfshirjes në veprimtarinë kriminale dhe me pas janë formalizuar duke investuar në pasuri të paluajtshme, në emër të të arfërmve siç është i padituri, subjekt i këtij ligji konform nenit 3/2/a të ligjit 10192/2009, i ndryshuar).

Edhe për objektin: Godinë shërbimi x-x katëshe, me Restorant x kat plus objekt ndihmës x kat, plus x kate shtesë në emër të Sh. S. B., pasuria Nr.xxxx, Zona Kadastrale xxxx, e regjistruar me datë xxxx, vlen i njëjti argumentim për mënyrën dhe kohën e vënies së saj (dhe të regjistruara në emër të të paditurit subjekt sipas nenit 3/2/a) të

ligjit.

Në zbatim të nenit 3 paragrafi 4 të Ligjit nr.10192/2009, i ndryshuar, jo vetëm pasuritë e vëna pasi ky ligj ka hyrë në fuqi i nënshtrohen hetimit pasuror, por edhe pasuritë të cilat janë vënë para se ligji të ketë hyrë në fuqi, por me kusht që këto pasuri të jenë vënë gjatë kohës që personi dyshohet të jetë përfshirë në veprimtarinë kriminale, në një nga veprat penale të listuara në nenin 3/1 në një nga pikat e këtij paragrafi.

Në nenin 3 paragrafi 4 sanksionohet shprehimisht: *“Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtari kriminale, sipas këtij ligji”*.

Në rastin konkret, në gjykim rezultoi se përfshirja në veprimtarinë kriminale përket me datë të hershme që në vitin 1994, dhe sidomos në periudhën 2004-2009, dhe se pasuria është vënë në këtë periudhë, por që realisht është formalizuar në vitin 2013, ç’ka në këtë rast, e gjithë pasuria i nënshtrohet hetimit pasuror në zbatim të këtij ligji.

Referuar kontratave të shitblerjes, (lidhur ndërmjet Sh. B. dhe trashëgimtarëve të I. A.), regjistrimit të kësaj prone pranë organeve shtetërore Publike, praktikës së ALUIZNI-t, lëvizjes në llogaritë bankare, pronat figurojnë të regjistruara në vitin 2013, por që realisht janë vënë gjatë përfshirjes në veprimtarinë kriminale (që do të argumentohet edhe më poshtë), dhe pas hyrjes së ligjit në fuqi.

Lidhur me pasurinë Nr.xxxx, nisur nga akti i ekspertimit vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe shpjegimet në seance të ekspertes L. B., legalizmi i objektit është bërë në datë xxxx. Në fotografimin ajror deri në muajin Shtator 2012 ky objekt nuk ka ekzistuar, kjo do të thotë që punimet kanë filluar pas Shtatorit të vitit 2012. Atëherë jemi në vitet 2012, 2013, 2014, kemi edhe 2015 deri në sekuestrim. Është marrë një mesatare vitin 2014 sepse çmimet e vitit 2014 janë analizë e një viti më parë. Në të njëjtën kohë kemi një dokument të blerjes së tokës, truallit, i cili është në vitin 2013, që do të thotë se investimi ka filluar pak më përpara por jo pa zgjidhur konfliktin me tokën. Deri në momentin e konfiskimit në vitin 2015 ka qenë duke u punuar atje, janë vendosur dritaret. Nga 2012-ta, deri në vitin 2015 është marrë mesatarja, viti 2014. Përderisa një objekt i tillë nuk mund të ndërtohet në një ditë, do të thotë që shtrihet në një kohë të caktuar.

Por gjykata çmon, se edhe nëse palët mund të kenë arritur de facto një marrëveshje të tillë më para se data xxxx, dhe pala e paditur të ketë filluar ndërtimin e objektit Nr.xxxx, para kësaj date, gjithësesi ky objekt nuk ka filluar të ndërtohet para vitit 2012, përsëri kjo periudhë përfshihet pas hyrjes në fuqi të ligjit 10192/2009.

Duke qenë se u provua sa më sipër, bazuar në nenin 21/3 e ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi.

Përsa i përket barrës së provës se pasuria është vënë në mënyrë të ligjshme, pala e paditur nuk provoi se pasurinë e ka vënë në mënyrë të ligjshme në kushtet kur siç u argumentua me sipër ai është subjekti i Ligjit.

Gjykata çmon se organi i akuzës gjatë gjykimit, ka paraqitur prova se pasuria e të paditurit nuk është vënë në mënyrë të ligjshme, ndërsa pala e paditur nuk paraqiti prova për të vërtetuar ligjshmërinë e pasurive të tij, ose provat me të cilat kërkoi të provonte një pretendim të tillë, nuk kanë vlerën e të provuarit të fakteve të pretenduara.

Nisur nga tërësia e provave shkresore me fuqi të plotë provuese, dhe të transkriptuara në regjistrat Publikë (të pasqyruar edhe në aktin e ekspertimit Vlerësues të pasurive të paluajtshme, i titulluar Akt ekspertimi Tekik, nga ekspertja D. B.), provohet se: Pasuria Truall me sipërfaqe parcele ndërtimore xxxx (xxxx)m², zona kadastrale xxxx, ndodhur në Lagjen “”xxxx” xxxx, për herë të parë është rregjistruar me Nr.Hip.datë xxxx, pas Vendimit Nr.xx, datë xxxx, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronavë, rregjistruar si bashkëpronar Sh. G. dhe F. A. (trashëgimtarë të I. A.). Ky rregjistrim është transkriptuar me datë xxxx, në regjistrin hipotekor, dhe pas Kontratës së datës xxxx, ndërmjet Sh. B. dhe bashkëpronarëve sa më sipër, me datë xxxx, është bërë transkriptimi në emër të shtetasit Sh. B..

Ndërsa objekti me Nr.pasurie xxxx, që është i ndërtuar mbi truallin sa më sipër, është legalizuar me datë xxxx, me sipërfaqe totale ndërtimore xxxx m², në emër të shtetasit Sh. B..

Pas shqyrtimit të një sërë provash të cituara edhe më sipër, ku organi i akuzës i është drejtuar të gjitha institucionve të cilat mund të kenë të dhëna për pasuritë e të paditurit apo familjarëve të tij, nuk rezulton që ai apo familjarë të tij të kenë zotëruar pasuri të tjera apo aktivitet ekonomik apo bujqësor siç pretendon i padituri.

Referuar shkresave të QKR dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore xxxx, rezulton se nga verifikimi i kryer mbi bazën e emrit, rezulton se shtetasi I.K., i datëlindjes xxxx, figuron të jetë si përfaqësues ligjor dhe ortak i shoqërisë xxxx, me NIPT xxxx.

Por në bazë të këtyre provave shkresore, sqarohet se fillimi i aktivitetit të këtij subjekti tregtar është me datë xxxx, **me status ligjor Sh.P.K. Nga ana QKL, është provuar se nuk është marrë leje apo autorizim për ushtrimi të veprimtarisë tregtare.**

Gjithësesi, gjykata pavarësisht nëse ky subjekt tregtar ka ushtruar ose jo veprimtari tregtare, dhe se çfarë të ardhurash ka siguruar, ato nuk mund të merren parasysh në rastin konkret, duke patur parasysh se pasuritë objekt konfiskimi janë vënë para se ky subjekt tregtar të ekzistonte (pasuritë janë vënë dhe regjistruar para vitit 2014, ku ka filluar aktivitetin ky subjekt).

Gjatë gjykimit me kërkesë të palës së paditur dhe përfaqësuesit të palës së tretë, gjykata urdhëroi kryerjen e ekspertimit Kontabël, për të përcaktuar ndër të tjera se cila ka qenë situata financiare e shtetasit Sh. B. dhe familjarëve të tij në datë 01 Janar 1994. Kjo me qëllim që të ndaheshin nga hetimi pasuror, pasuritë e vëna para se subjektet të përfshiheshin në veprimtari kriminale. Nga ana e ekspertes, u theksua se nuk mund të përcaktohet situata financiare e shtetasit Sh. B. dhe e familjarëve të tij, as të ardhurat dhe as shpenzimet, pasi nuk ka prova në lidhje me situatën ekonomike e financiare në periudhën 01 Janar 1994, ku megjithëse palët kishin kohë të paraqitnin prova në këtë drejtim, nuk paraqiten asnjë provë.

Nga **akti i ekspertimit kontabel i datës xxxx** i hartuar nga eksperte kontabël e autorizuar F. S. del se nuk mund të kryhen llogaritje dhe të nxirren përfundime për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Sh. B. dhe familjarët e tij ashtu dhe për shpenzimet e këtij shtetasi e familjarëve të tij deri në datën 1 Janar 1994. Ndërsa për sa i përket periudhës nga Janar 1994 e deri në Mars 2014, vlera totale e depozitave të përbashkëta të paditësve Sh. B. e M. B., bashkë me vlerat e interesave dhe vlerën e deklaruar nga shitja e bagëtive në Nëntor 2006, shkon në shumën xxxx lekë. Për të ndjerin I. k. del se ka mjete monetare të raportuara si hyrje në euro për periudhën 2012 – 2014 në llogari bankare në vlerën xxxx euro ose xxxx lekë.

Totali i mjeteve financiare të përdorura nga shtetasi Sh. B., i shprehur në lekë është xxxx lekë. Në lidhje me raportin në mes të të ardhurave dhe shpenzimeve të shtetasit Sh. B. për periudhën 1 Janar 1994 – Mars 2014 nga akti i ekspertimit del se shuma e mjeteve monetare për periudhën në fjalë është xxxx lekë dhe rezulton që të ketë një mungesë likuiditeti në shumën xxxx lekë.

Në lidhje me detyrat për përcaktimin e situatës finnciarë të personave të tretë Ekspertja ka hartuar një raport përmbledhës e sqarues me datën xxxx. Ekspertia ka dhënë sqarimet në seancë gjyqësore i pyetur nga përfaqësuesi i palës së tretë duke sqaruar se meqënëse ato janë deklarata noteriale nuk vërtetohet që janë të ardhura në posedim të personave të tretë.

Sipas marrëveshjes se huasë jo noteriale, datë xxxx midis H. M. dhe B. M., për vlerën totale të borxhit prej xxxx euro ne vitet 2011-2012, dhënë nga H. M., B. M. me afat shlyerjeje deri në datë xxxx pa interesa, është e përfshirë brenda shumës xxxx euro edhe vlera e huasë prej xxxx euro marrë prej tij në datë xxxx, duke ju përgjigjur pyetjes së gjykatës se cila ka qenë gjendja në datë 03 Mars. Ai në datë 03 Mars ka marrë xxxx euro nga H. M.. A është e ardhur apo nuk është, nuk e them dot sepse është kontratë huamarrje. Në deklaratën noteriale me Nr.xxx Rep. dhe Nr.xxxx Kol, datë xxxx “Për marrje përsipër nga Sh. B. të borxhit të të birit të ndjerë I. K.”, ndaj B. M. në vleren xxxx euro, me interes vjetor 2% sipas datave të borxhit deri në datën e shlyerjes së tyre, është e përfshirë njohja e borxhit prej xxxx euro.

Nga akti i ekspertimit të kryer nga eksperte vlerësuese L. B. i datës xxxx, është bërë vlerësimi mbi pronat truall me sipërfaqe xxxx m katror, xxxx dhe i

një godine shërbimi x-x katë me restorant x kat e një ambienti ndihmës në katin x me sipërfaqe totale xxxx m katror. Sipas aktit të ekspertimit vlera e shitblerjes së trualit është xxxx lekë. Sipas kontratës së kaparit vlera është xxxx Euro.

Ndërsa godina x-x katë me restorant x kat e një ambienti ndihmës në katin x me sipërfaqe totale xxxx m katror ka si vlerë në momentin e kryerjes së aktit atë prej xxxx lekë.

Si nga pala e paditur, ashtu edhe nga palët e treta u paraqitën me cilësinë e provave disa deklarata noteriale ku i padituri Sh. B. njihte “borxhet” që djali i tij, i ndjeri I. K. kishte marrë tek personat e tretë. Këto deklarata nuk kanë vlerë provuese pasi ne vetvete ato tentojnë të provojnë shkëmbimin e mjeteve monetare mbi bazën e përgjegjësisë personale që ka deklaruar gjithësecili. Por hyrje dhe dalje të mjeteve monetare në llogaritë bankare nuk ka, ka vetëm shkëmbim të mjeteve monetare jashtë këtyre kanaleve. Sipas vlerësimit të ekspertës kontabël, këto shkëmbime nuk mund të llogariten si të ardhura. Megjithatë, gjykata do të analizojë përmbajtjen e tyre referuar dhe kohës në të cilën janë hartuar ato.

Procedimi Procedimit Penal, Nr.xxx, viti xxxx, që bën fjalë për veprën penale të “Pastrimit të Produkteve të veprës penale, parashikuar nga neni 287 i K.Penal, nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, është regjistruar që me datë xxxx, dhe të gjitha deklarata noterale janë bërë pas kësaj date, pra pas vënies në dijeni se ndaj tyre po kryheshin hetime, madje pothuajse të gjitha janë bërë pas regjistrimit të Procedimit Pasuror me datë xxxx, ku e vetmja Deklaratë ndërmjet të paditurit dhe personave të tretë që mban datën xxxx, është ajo ndërmjet Sh. B. dhe A. G..

Por konstatohet se gjithsesi, kjo deklaratë është mbajtur pas nisjes së materialit nga Prokuroria e xxxx për në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, me shkresën Nr.xxxx, datë xxxx, dhe pasi ishte pyetur si person që ka dijeni për rrethanat e hetimit, kohë më parë kësaj shkrese.

Duke i marrë me radhë këto Deklarata konkludohet se:

- Lidhur me aktin noterial “Deklaratë Noteriale” Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, ku nënshkruesit janë **A. G. dhe Sh. B.** ku theksohet se:....*Sh. B. deklaroj se nën përgjegjësinë time ...i ndjeri djali im I. B. ka marrë prej Z.,A. G.j që prej muajit Janar të vitit 2013, shumën prej xxxx (xxxx) euro, me një interes vjetor prej 8% në vit, për ndërtimin e një hoteli i cili ndodhet në L.xxxx që familja ime ka ndërtuar.unë si baba i tij marr përsipër detyrimin për të garantuar huadhënësin se detyrimi i të ndjerit djalit tim do ti kthhehet bashkë me interesat ashtu siç e kishim parashikuar në marrëveshjen e tyre...*” fiktiviteti i saj qëndron në kohën e kryerjes së veprimit dhe në përmbajtjen e saj.

Lidhur me kohën e kryerjes së veprimit, i padituri (ndoshta edhe më parë por) të paktën që

me datë xxxx, kur është pyetur me cilësinë e personit që ka dijëni për veprën penale (për procedimin penal Nr.xxxx), ka ardhur në dijëni se për pasuritë e tij dhe të familjarëve, po kryheshin hetime në bazë të nenit 287 të K.Penal, dhe që pas kësaj date ka hartuar deklaratat sa më sipër.

Fiktiviteti i një veprimi të tillë juridik, qëndron edhe në përmbajtje të saj. Kjo pasi Sh. B., i cili nuk kishte të ardhura, merr përsipër një borxh në një shumë të tillë dhe aq më tepër në emër dhe përllogari të të birit, që ai kishte vdekuar tashmë (para rreth një viti), madje duke shënuar I. B., ndërkohë që ai kishte ndërruar mbiemrin që në vitin 2004 në K..

Gjatë gjykimit, nuk u paraqit asnjë provë (*që të mbështeste këtë pretendim*) që të vërtetonte se ndërmjet A. G. dhe Sh. B. apo I. K., të kishte patur ndojë veprim juridik apo transaksion bankar. Pavarësisht se personi i tretë u mundua të provonte se ai në “kohën kur kishte dhënë këtë borxh, që rezultoi fiktiv” për të kamufluar prejardhjen e vërtetë të parave, kishte patur mundësi monetare nga aktiviteti i “Kambizmi”, duke paraqitur dëshmitarë dhe disa akte të një dosje hetimore, ai nuk e provoi një fakt të tillë.

Kjo pasi ndër të tjera në vendimin e Pushimit të çështjes cituar sa më lart, theksohet se nuk provohet që ai të ketë ushtruar një veprimtari të tillë. Në dosje nuk u paraqit asnjë akt shkresor zyrtar, që të vërtetonte një pretendim të tillë. Gjithësesi edhe nëse personi i tretë ka patur në mënyrë ilegale një shumë të tillë, nuk provohet t’ja ketë dhënë ato shtetasit I. K. alias I. B., apo personave të tjerë të familjes B.. Deklarata noteriale cituar sa më lart, ku merren përsipër detyrime, borxhi të paqena: veprime juridike të bërë me marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike, duke kryer kështu një veprim juridik nul, fiktiv, të paqenë, ku në bazë të nenit 92/ç të K.Civil, janë absolutisht ta pavlefshme të cilat Gjykata i konstaton edhe kryesisht pa patur kërkesë të palëve.

I njëjti argument është edhe për deklaratat: Deklaratë Noteriale Nr.xxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, nënshkruar nga **H. M. dhe Sh. B., ku I. K. alias I. B. ka marrë hua** Z.H. M. që prej muajti Tetor 2012, shumë prej xxxx (xxxx) euro, me një interes prej 5% në vit, Deklarataë Noteriale Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, nënshkruar ndërmjet **A. M. dhe Sh. B.,** ku deklarohet se I. B. (K.), ka marrë hua një shume prej xxxx (xxxx) euro me datë xxxx, në Shqipëri, me interes xxxx Euro në muaj Zotit A. M., Deklaratë Noteriale Nr.xxxx rep, Nr.xxxx Kol, datë xxxx, ku deklarohet se I. B. ka marrë prej Z.B. M.a në muajin Mars të vitit 2011, shumë prej xxxx (xxxx) Euro, në muajin Qershor të vitit 2011, shumë prej xxxx (xxxx) Euro, dhe në muajin Shkurt 2012, shumë prej shumë prej xxxx (xxxx) Euro, në total prej xxxx (xxxx) Euro me një interes prej 2% në vit, për ndërtimin e një hoteli në Lagjen “xxxx“ xxxx, që famija ka ndërtuar.

Personat e tretë në këtë gjykim u munduan të provonin se ata në “kohën e dhënies së këtyre

shumave hua” i kishin këto shuma në dispozicion. Ajo që vlen edhe në këtë rast është se as palët e treta dhe as i padituri nuk paraqitën asnjë një provë të vetme që të konfirmojnë një marrëdhënie detyrimi (apo edhe marrëdhënie tjetër biznesi), ndërmjet tyre dhe I. K. alias B., apo Sh. B.. H. M. pretendsoi se kishte patur shuma të konsiderueshme pasi nëna e tij kishte shitur prona të paluajtshme dhe se këto shuma i kishte administruar vetë ai. Edhe nëse merret i vërtetë fakti që ai i ka disponuar këto shuma parash, nuk provohet t’ja ketë dhënë këto I.K. alias B..

Edhe personat i tretë A. M. dhe B. M., pretenduan se kanë patur mundësitë dhe paratë i kanë patur në gjendje kur i kanë dhënë “borxh”, por edhe për këta persona vlen i njëjti argument ku nuk provojnë se këto shuma t’ja kenë dhënë borxh të paditurit apo familjarëve të tij siç ishte I. K. alias B..

Argumentimi për fiktivitetin e këtyre deklaratave mbetet i njëjtë përse i përket kohës dhe përmbajtjes së tyre. Kjo pasi ato janë hartuar vetëm pasi pala e paditur ka ardhur në dijeni të procedimit pasuror ndaj tij, dhe se ai pa patur të ardhura merr përsipër “si detyrime borxhi” shuma të konsiderueshme jashtë çdo lloj llogjike dhe mundësie që ato të mund ti shlyente. Aq më tepër që ai po njihte borxhe të marra në emër dhe për llogari të të ndjerit I. K., ku ky i fundit kishte rreth një vit që kishte vdekur.

Gjykata çmon se edhe pse Kodi Civil, nuk kërkon ndonjë formë të veçantë për kontratën e Huasë, përsëri ato për të garantuar shlyerjen e tyre, dhe për t’ju përmbajtur kushteve duhet që në kohën e arritjes së marrëveshjeve, ato të formalizoheshin. Aq më tepër kur bëhet fjalë për shuma të konsiderueshme sa më sipër, për interesa dhe për afate shlyerjeje.

Një tjetër argument që e bind gjykatën në fiktivitetin e këtyre veprimeve juridike, është se palët nuk paraqiten qoftë edhe një faturë bankare apo të thjeshtë të kohës që tregonte për kalimet e këtyre shumave nga njëra palë tek tjetra, apo shlyerjes së kësteve apo interesave.

Pretendimi që H. M., kishte lidhje krushqie me I. K., dhe për këtë arsye nuk kishin mbajtur kontratë në kohën e marrëveshjes së huasë, pala e tretë nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar se në çfarë shkallë është kjo lidhje krushqie, por edhe po të jetë sipas pretendimit të saj, gjykata nuk çmon se është në rrethin e subjekteve të cilëve nuk mund t’ju kërkosh mbajtjen e një kontrate. Në bazë të ligjit Nr.10192/2009 i ndryshuar, dhe K.Pr.Civile, palët kanë barrë e provës për të vërtetuar faktet e pretenduara.

Një tjetër argument që bind gjykatën në fiktivitetin e veprimeve juridike sa më lart, është se palët e treta nuk paraqiten asnjë provë në mënyrë që të llogariteshin shpenzimet e tyre dhe familjarëve të tyre. Pra për të verifikuar se vërtetë shumat që ata pretendonin ti kishin, i kanë patur gjendje kesh apo si ishte raporti i tyre me shpenzimet.

Lidhur me: Deklaratë Noteriale Nr.xxxx Rep. Nr.xxxx Kol, datë xxxx, hartuar nga noteri sipas deklarimeve të Sh. B., ku ndër të tjera pasqyrohet: Sh. B.,

ka deklaruar se ka pasur në pronësi një tufë bagëtish (Dhi), prej xx (xxxx) krerë si dhe xx krekë lopë, që nga 1991-2006, dhe i ka shitur duke realizuar të ardhura prej xxxx (xxxx) Lekë, po ashtu nga shitja e Lopëve ka siguruar të ardhura rreth xxxx (xxxx) Lekë, të cilat i ka investuar në ndërtimin e hotelit në xxxx, së bashku me djemtë e tij, Gjykata çmon se edhe kjo deklaratë është fiktive. Kjo duke u nisur nga koha e hartimit, pra pasi ishin vënë nën hetim pasuror (vlen arsyetimi sa më lart) dhe nga përmbajtja.

Nga pala e paditur, nuk u paraqit asnjë provë që vërteton ushtrimin e një aktiviteti të tillë, qoftë nga autoritetet lokale të kohës apo ato Rajonale (siç mund të ishin Drejtoria e Bujqësisë, Komunitat, apo autoritete tjera kompetente), që të vërtetonte një pretendim të tillë.

Pra tërësia e veprimeve si në formë ashtu edhe në përmbajtje tregojnë për një fiktivitet të veprimeve juridike të tilla, dhe qëllimi i vërtetë i tyre ka qenë “legalizimi, formalizimi” i shumave të konsiderueshme, për të kamufluar prejardhjen e parave nga aktiviteti kriminal i personave subjekte të nennit 3 të Ligjit 10192/2009 i ndryshuar, dhe si të tilla ato janë nul duke u konsideruar si absolutisht të pavlefshme. Ndër të tjera në vendimin Unifikues Nr.5/2012 theksohet se: *Veprimi juridik që është i pavlefshëm mund të merret parasysh nga gjykata edhe kryesisht, pa u kërkuar nga pala e interesuar, madje edhe kundër vullnetit (dëshirës) të saj.*

Për të konsideruar një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm nuk është e nevojshme paraqitja e një kërkesë të posaçme, qoftë kjo padi apo kundërpadi, pasi kjo lloj pavlefshmërie konstatohet pavarësisht nga paraqitja në gjykatë e kërkesës....”.

Gjykata çmon se edhe pse palët nuk kërkuan konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike sa më lart (madje pala e paditur pretendoi se duke qenë se Prokuroria nuk e ka pretenduar gjykata nuk mund t’i kostatojë), ata janë veprime juridike nul, të paqena dhe si të tilla nuk mund të sjellin pasoja juridike, duke u konstatuar si të tilla.

Përsa i përket kontratave të lidhura nga palët e treta njëri me tjetrin apo me persona të tjerë, duke qenë se nuk passjellin pasoja në këtë gjykim gjykata nuk shprehet për to, pasi dalin tej objektit të këtij gjykimi.

Lidhur me shumën e pretenduar prej xxxx Euro, të cilat sipas palës së paditur kanë qenë të ardhura të x pjetarëve të familjes xxxx në shtetin Italian, sa më sipër u theksua se provat që kërkohen të vërtetohet një fakt i tillë nuk kishin formën (nuk kanë vulë apostile, apo të konfirmuara forma e tyre nga organet që kanë detyrim për t’i lëshuar). Në kushte të tilla, nuk mund të gjykohet fare mbi përmbajtjen e tyre, dhe se gjykata nuk i ka marrë në shqyrtim prova të tilla, në këto kushte kjo shumë nuk mund të llogaritet në të ardhurat e familjes xxxx.

Duke qenë se pala e paditur ishte vënë në dijeni që në xxxx, se ndaj tyre kishte filluar një hetim pasuror, ata kishin detyrimin në bazë të nennit 21/3 dhe 22 të Ligjit 10192/2009, i

ndryshuar, të paraqisnin në formën e kërkuar nga ligji çdo provë që të vërtetonte ligjshmërinë e këtyre pasurive. Gjithashtu duke patur parasysh kohën që nga xxxx, dhe deri në dhënien fund të hetimit gjyqësor me datë xxxx, kanë patur edhe kohën e mjaftueshme për të paraqitur këto prova për të vërtetuar faktet e pretenduara.

Lidhur me transfertat bankare, gjendjet e llogarive rrjedhëse, apo depozitave, të familjarëve të famijes xxxx, duke qenë se nuk provohet se asnjëri prej tyre të ketë ushtruar aktivitet të ligjshëm, apo të kenë krijuar të ardhura të ligjshme, edhe këto shuma nga ana e Gjykatës nuk mund të merren parasysh si të ardhura e tyre të ligjshme, duke qenë se prejardhja e tyre është nga aktiviteti kriminal.

Shpenzimet që ka patur Sh. B. si në investim (xxxx lekë), bjerje mjeti transporti, shpenzimet për jetesë (xxxx etj), si dhe faktin që asnjë nga shumatat e pretenduara si të ardhura nuk provohet të ketë prejardhje të ligjshme, raporti të ardhura/shpenzime del me vlera negative dhe në këto kushte nuk justifikohet asnjë vlerë sado të jetë ajo.

Gjykata çmon se plotësohet edhe kushti i parashikuar nga neni 24/1/c, ku defacto vlerat monetare për blerjen dhe vënien e pasurive objekt konfiskimi janë realizuar nga djemtë e të paditurit, dhe se zotërues de jure është Sh. B.. Në këtë rast, gjykata konstaton se plotësohen në mënyrë komulative të tre kushtet që kërkon neni 24 i ligjit për pranimin e kërkesës për konfiskim.

Lidhur me pretendimin se akti i ekspertimit kontabël është i metë dhe nuk ka marë parasysh deklaratat noteriale apo dëshmitë e dëshmitarëve, ky pretendim nuk është i bazuar në ligj. Ekspertja Kontabël mbështetet vetëm në provat që ndodhen në dosjen gjyqësore, dhe ka si detyrim ligjor që të marrë parasysh nga pikëpamja ekonomike, vetëm aktet që parashikon Ligji për Kontabilitetin (dhe aktet nënligjore), Ligji në fushën e tatim/taksave (që njihen si fatura të rregullta ligjore apo formular të miratuar), dhe jo çdo akt që paraqesin palët apo dëshminë e dëshmitarëve.

Është Gjykata ajo, që pasi i vlerëson të gjitha provat në tërësi, i çmon ato dhe vlerëson nëse ato provuan faktin e pretenduar nga pala që ka kërkuar ta vërtetojë ose jo. Caktimi i detyrave shtesë të ekspertes do të ishte i pavend, dhe vetëm do të sillte zvarritje të procesit duke patur parasysh se palët paraqiten vetëm ato prova që i kishin paraqitur që në fillim të shqyrtimit gjyqësor. Edhe kërkesën e përfaqësuesit të të paditurve për riçeljen e hetimit gjyqësor sipas nenit 304 të K.Pr.Civile, me qëllim marrjen e provave të reja nëpërmjet letërporosisë, nuk u gjet e bazuar nga gjykata pasi nuk plotësonte kushtet e kërkuara nga nenet 151 e 186 të K.Pr.Civile.

V.Shpenzimet procedurale.

Përsa i përket shpenzimeve gjyqësore, gjatë këtij procesi janë kryer një akt ekspertimi

vlerësues dhe një akt ekspertimi kontabël, nga ku gjykata ka parapaguar shumën e tre akteve sipas rregullave finaciare të parashikuara më aktin nënligjor përkatës dhe pagesa është bërë konform faturave tatimore të shitjes. Shpenzimet hetimore të hetimit pasuror, shpenzimet gjyqësore sipas formularit bashkangjitur, parapaguar nga shteti, i ngarkohen të paditurit Sh. B.. Kjo në zbatim të nenit nenit 25 pika 3 të ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar.

VI. Ekzekutimi i vendimit dhe administrimi i pasurive objekt konfiskimi.

Gjykata çmon se është i bazuar edhe kërkimi i Prokurorisë përse i përket institucioneve të ekzekutimi të vendimit dhe administrimit. Në këto kushte, për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, administratori E. B. (sipas kërkesës së Prokurorit). Kjo bazuar në nenin 34 të ligjit dhe dispozitat vijuese të ndryshuar me ligjin nr. 70 /2017.

Përse i përket të drejtës së ankimit kundër vendimit për konfiskimin e pasurisë, në nenin 27 pika 2, të ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, është parashikuar e drejta e ankimit sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në Kodin e Procedures Civile, (*meqënëse çështje po gjykohet sipas këtyre rregullave*) dhe se ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit.

Ankimi në Gjykatën e Apelit sipas K.Pr.Civile, parashikohet në nenin 443/2 të tij, i cili është 15 ditë, dhe duke qenë se ligji nuk parashikon ndryshe, gjykata çmon se edhe në rastin konkret vlen ky rregull për ankimin.

PËR KËTO ARSYE.

Gjykata, bazuar në nenet 3, 7/2,12/5 21-28, të ligjit Nr.10192, date 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” i ndryshuar me ligjin nr.70/2017, nenet 126, 306 – 310 të K.Pr.Civile,

VENDOSI

1. Pranimin e padisë së Prokurorisë pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë.
2. Konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të pasurive të paluajjtshme të sekuestruara me vendimin Nr. xx datë xxxx, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda si më poshtë:
 - Objekti truall me numër pasurie me sipërfaqe parcele ndërtimore xxxx m², zona kadastrale xxxx, lagjia ”xxxx“-xxxx, me pronar Sh. B..
 - Objekti ndërtesë xxxx kate me sipërfaqe totale xxxx m², me numër pasurie xxxx-Nd, zona kadastrale xxxx, lagjia “xxxx” xxxx, i regjistruar në emër të

Sh. B..

3. Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra Përmbarimore xxxx dhe Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, administratori pranë këtij institucioni, E. B..
4. Urdhërohet kryesekretaria pranë kësaj gjykate, që t'i komunikojë një kopje të këtij vendimi Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, si dhe Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor xxxx.
5. Shpenzimet hetimore të hetimit pasuror, shpenzimet gjyqësore (sipas formularit përkatës), përsirë dhe shpenzimet për ekspertimet të kryera gjatë gjykimit në masën 120.000 lekë (njëqind e njëzet mije) lekë, të parapaguara nga shteti, i ngarkohen të paditurit Sh. B..
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmeja e shpalljes në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ankimi i cili nuk pezullon zbatimin e këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 18.05.2018.

SEKRETARE
Alma RAMAJ

GJYQTAR
Sandër SIMONI